



D R I T A

"Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon."

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Korrik/Gusht 2007 • Viti XXIV • Nr. 3/4 (155) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



FESTA E ZOJËS CËRNAGORE NË LETNICË.

Më 15 gusht solemnisht u kremtua festa e të Ngriturit e Zojës në qiell me shpirt e me trup.

FAQE 2-3



LETËRSIA E ATË GJERGJ FISHTËS

FAQE 16-17

(Shkruan: NDUE UKAJ)

DUKURIA E SË SHENJTËS DHE RELIGJIONI (2).

Pandehmat e para mbi të shenjtën në religjion kanë buruar nga kraharori i etnologjisë dhe sociologjisë dhe janë mbështetur kryesisht në dy themele: "mana" dhe "totemi".

(Shkruan: DON ROBERT KOLA)

SEPARATI PËR FËMIJE



KËNDVËSHTRIM

Viti i ri shkollor

1. Pushimet verore që janë në fundin e saj ishin kohë relaksimi, kohë e volitshme e përqendrimit në gjëra tjera, që e ndihmojnë shpirtin e trupin për qetësi e prehje.

Që në fillimin e Krijimit hetojmë kuptimin e drejt të pushimit që ne të dimë ta përfetojmë kohën e pushimit si një aktivitet kundrimi, përqendrimit dhe mahnitjeje. Hyji kur e kreu krijimin e botës për gjashtë ditë, Ai të shtatën ditë *pushoi* nga veprimtaria e tij (khs. Zan 2, 2). Shkrimi i Shenjtë në mënyrë eksplicite thekson arsyen e pushimit dhe të shenjtërimit të ditës së shtatë. Hyji të shtatën ditë *e kundroi punën e duarve të veta, pa se ishte e mirë*. Ja esenca e pushimit si hapësirë dhe kohë estetike dhe etike e punës së njeriut, përkatësisht kohë kur peshohen të bëmat e njeriut gjatë ditëve të vitit përplot punë e angazhime me të ndryshme. Shenjtërimi i këtyre momenteve është me rrjedhë hyjnore për qëllim ngritjen, plotësimin dhe kthimin në thelbin e njeriut, në dinjitetin e tij.

Pushimi nuk është arratisje nga detyrat dhe përgjegjësit personale dhe kolektive, por kohë e meditimit kreativ mbi punën tonë, detyrat tona dhe përgjegjësitë. Për më tepër, janë ditë të përsiatjes për relacionet tona me Zotin dhe njeriut, të afërmin vëlla-motër. Nga kjo del se pushimet nuk mund të konsiderohen kohë e dëfrimit, arratisjes nga vetvetja, apo kohë e eksperimentimit mbi dinjitetin tonë a të tjerëve.

2. Pas pushimeve verore fillon viti i ri shkollor. Të pajisur me një kundrim të ri estetik-etik do të duhej të jemi të gatshëm për të dëgjuar tingëllimin e ziles shkollore. Atë zile që thërret për punë me plotë përgjegjësi. Çdo fillim i ri shkollor është një sfidë e re për arsimin, aq më tepër për arsimin tonë që, për fat të keq, ende nuk ka arritur të marr vetën. Të edukosh gjenerata të reja tek një popull është, pa dyshim, një sfidë dhe përgjegjësi e lartë për institucionin përkatës. Një përgjegjësi e këllëb bie mbi supet e ministrisë së arsimit dhe mbi mësimdhënësit që u është dhënë besimi për arsimimin e të miturve dhe rinisë, që nesër të mund të formohen si persona të përgjegjshëm për shoqërinë tonë kosovare. Njëkohësisht, pranë besueshmërisë që mbajnë mësimdhënësit, kanë përgjegjësinë e lartë për zhvillimin e shoqërisë që po lind, e asaj ardhmërie që do duhej të ishte krahpërkrah me qytetarët evropian.

3. Është e pashmangshme, në këtë rast, të shtrojmë çështjen e nivelit tonë arsimor, ciklit parauniversitar, kushtet ambientale, kuadrot arsimore dhe shpërbërimit të tyre. Mos të harrojmë se një shoqëri pa arsim dhe kulturë s'ka si të udhëheqë vetën, s'ka si të dijë të shmangë rreziqet e jashtme e të brendshme ndaj qenësisë etnike, kombëtare, kulturore e fetare. E në anën tjetër mos të na ikët kundrimi i metodologjisë dhe masat që duhen marrë për të arritur nivelin e duhur, për të arrirë nivelin ku do jetë arsimi, shkollimi foleja e kultivimit të vlerave dhe rruga që na bashkon me kultura të përparura, që njeriun e formojnë si person.

Shën Benedikti – Pajtori i Evropës



Shën Benedikti, ati i rregulltarisë dhe kulturës perëndimore të krishterë në përgjithësi, u lind rreth vitit 480 në Norça, afërsisht 80 km nga Roma, në një familje të pasur e cila ia mundësoi atij studimet e retorikës dhe filozofisë në Romë. Jetoj në një kohë kur në Romë shpeshohesh në një kthim të shkëlqimit të dikurshëm antik që kishte Qyteti i Amshuar. I pakënaqur me gjendjen politike e fetare në Romë, e cila ishte zhytur në një jetë hedoniste të shfrenuar e pa ideale, i la studimet dhe u tërhoq në vetmi në një shpellë afër vendit Subiaca. Aty i kaloi tri vite në lutje e meditim të thellë, një jetë murgu vetimtar, që ia mundësoi krijimin e personalitetit të shenjtë. Papa Gregori i Madh do të thotë: *"Ishte një njeri i ndershëm, me emër Benedikt, i bekuar me hir e me emër (shq. Bekim). Në vete*

mbarte urtinë e një plaku. Më parë i pjekur me karakter se sa me vite". Qysh në moshë të re Benedikti reflektohte me një shpirt të një njeriu të madh, dhe shumë të rinjë do ta ndjekin shembullin e tij. Ky murg me karakter të fortë, kulturë të lartë dhe vizione të qarta, për qëllimin e jetës së ndershme të krishterë do të themelojë rregullat e murgërisë perëndimore, që janë një libër i shekujve, edukatore e të gjitha kohërave. Edhe sot shumë kuvende rregulltare ndjekin rregulloret e jetës benediktine.

Kuvendi i parë dhe më i njohur benediktin i themeluar nga vetë Shën Benedikti është Monte Cassino. Aty Shën Benedikti do të ketë shumë vizita nga ana e ipeshkvijve dhe mbretërve të ndryshëm, personaliteteve tjera të shumta, njerëz besimtarë e paganë të cilët do të konvertohen në fenë e krishterë. Të gjithë i mrekullonte urtësia dhe guximi i tij, qëndrimi ndaj gjërave qiellore e tokësore, dëshira për të vepruar gjithëherë mirë e drejtë, bazuar në mësimin e Shkrimit të Shenjtë.

Për veprimtarinë e Shën Benediktit, më së shumti mësojmë në librat mbi *Dialogjet*, të Shën Gregorit të Madh. Dëshmitë e Shën Gregorit na bëjnë të kuptojmë se Shën Benedikti zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin e kulturës dhe civilizimit Perëndimor në përgjithësi. Sidomos libri i dytë, *Dialogjet*, flet për jetën dhe mrekullitë e këtij shenjtë, pastaj, disa kapituj flasin për shkathtësitë dhe dhuntitë tjera që mund t'i ketë vetëm një njeri i shenjtë. Ai jetoj në një periudhë kur udhëhegës barbar pushtonin pjesë të perandorisë romake, por edhe kur definitivisht po mbyllej kapitulli i dominimit romak, kështu që, mbijetesa e vlerave të

mirëfillta dhe kulturës së tij do të mëvarej nga angazhimi i madh në sferën religjioze dhe kulturore të murgjve. Shën Benedikti nuk është themelues i jetës rregulltare të krishterë në përgjithësi, pasi që ka jetuar dy deri tre shekuj më vonë pas themelimit të tyre në Egjipt, Palestinë e Azi të Vogël. Por, pa mëdyshje rregulltarisë i dha një kahje të re sidomos me Rregullat të cilat i shkroi për jetën e murgjve, e të cilat janë përdorë dhe vazhdojnë të përdoren edhe sot në shumë Kuvende të botës. Ideali i këtij njeriu të dashur dhe konkret, vullneti për të krijuar rend më të madh në bashkësitë dhe Kuvendet ekzistuese, e shtynë që të shkruaj Rregullat të cilat përmbledhin në një moto shumë praktike: *"Ora et labora"* - *"Lutje dhe punë"*. Kështu, ai i ktheu askezën së krishterë karakterin e përshtatshëm në të madh në fe, por edhe të veprimtarisë konkret bazuar në Ungjill. Me Shën Benediktin hapet një kapitull i ri i lavdishtëm i rregulltarisë perëndimore.

Kuvendet, këto vatra të lutjes dhe punës, do të bëhen vendet kyqe në të cilat do të ruhen me shekuj shkrimet e vjetra. Poashtu, aty do të krijohet një thesar i madh shkrimesh të reja të cilat do të jenë themele të ndërtimit të rendit të ri shoqëror, civilizimit të cilin e gëzon sot Evropa. Pra, kjo kulturë e ruajtjes dhe kultivimit të vlerave jetësore për zhvillim të përgjithshëm, që ishte e pranishme dhe rritej dita ditës nëpër Kuvendet e krishtera, do të jetë kontribut i paçmueshëm i krijimit edhe të identitetit të krishterë evropian.

Prandaj, duke marrë para sysh kontributin e Shën Benediktit, me të drejtë, me rastin e shulguimit të kuvendit të renovuar të Monte Cassino-s më 1964, Papa Pali VI, e shpalli atë pajtorin e kontinentit të Evropës, duke marrë zyrtarisht vendin e merituar edhe nga ana e Kishës. Por, as kjo nuk mjafton për derisa kontinenti ynë nuk iu kthehet vlerave dhe rregullave të atyre që ia trasuan asaj rrugën e zhvillimit, siç potencon edhe Papa i sotshëm Benedikti XVI.

Don Agim Qerqini



Qindra kisha dhe kambana të qytetit të Shasit gjatë mesjetës

FAQE 14-15

Shkruan: Prof. Dr. Jahja DRANÇOLLI

Intervistë me Imzot Zef Gashin, arqipeshkëv i Tivarit

Kosova e orientuar drejt Perëndimit do t'i realizojë aspiratat e saj

FAQE 12-13



Mesha solemne më 15 gusht në Letnicë



Qiriu i sjellë nga shenjtërorja e Lurdit



“Të ngriturit e Zoje Festa e Zojës Cërna

Ishte ditë e martë, 14 gusht, derisa udhëtonim në drejtim të Letnicës për të marrë pjesë në festën e “Të ngriturit e Zojës në qiell” që festohet në Letnicë, e njohur si *Zoja Cërna*, takuam rrugës shumë shtegtarë, të rinj e të reja, pleq e plaka, fëmijë e të rritur, nga famullia e Binçës dhe Stubllës, me rruzare në dorë, disa prej tyre të zbathur që me përshpirtëri shtegtonin në drejtim të Shenjtërores. Sa më tepër afroheshim shenjtërores aq më tepër ngushtohet rruga prej shtegtarëve. Ishte një pamje e mahnitshme të kundroshe këta njerëz të përshpirtshëm në qëndrimin e tyre, të bashkuar në lutje e të gëzuar në fytyra; pamje e admirueshme, vërtet! Ky shtegtim tradicional tashmë tregon një gjallëri të veçantë të përshpirtërisë dhe fesë së gjallë të këtyre banorëve ndaj Virgjëres Mari, që nëpër shekuj u bë shenjë publike e përkatësisë së krishterë, Kishës dhe popullit tonë.

TRADITË SHEKULLORE E PËRSHPIRTËRISË NDAJ ZOJËS

Festimi i Zojës Cërnaore në Letnicë ka një traditë të lashtë që është krijuar shumë më herët. Në këtë shenjtërore është krijuar një përshpirtëri e veçantë mariane dhe është rritur dita ditës duke u pasuruar. Sot me mijëra shtegtarë, të krishterë (edhe ortodoks) e jo të krishterë (në veçanti mysliman) kur vjen 15 gushti e mbushin përplot Letnicën. Aty secili ka njetin e vet, lutjet e veta që ia drejton Nënës Qëllorë, dhe s'ka njeri të mos mahnitet nga një pamje e tillë ekumenike dhe ndërfetare.

Zakonisht, sipas traditës, festës së Zojës Cërnaore i para-prinë shtegtimi nëntëditor me meshë, këngë të përshpirtshme e rrëfime, që u zhvillua edhe sivjet në mënyrë shumë të organizuar. Sipas traditës natën e festës populli i Zotit e pret barin e vet, ipeshkvin e Kosovës, i cili do të

kremtojë meshën solemne me 15 gusht. Me që në të kaluarën ipeshkvi i vendit shtegtonte në Letnicë për një të ndryshme, edhe sivjet ipeshkvi jonë së bashku me meshtarët dhe popullin për një kryesor kishte “*Pagen dhe pajtimin ndërmjet popujve në Kosovë*”, që vendi ynë të gëzojë pagën e vërtetë.

Festa fillon me meshën e vigjiljes që sivjet e kremtoj Imzot Lucjan Avgustini, ipeshkëv i Sapës – Shqipëri, me bashkëcelebrim me meshtarë. Në mbarim të meshës në mënyrë solemne u ndez qiriu i madhe i vendosur në altarën e madh përball kishës, e që ishte dhuratë e misionëve tona në Evropë i sjellë enkas për këtë ditë prej Shenjtërores së Lurdit. Pas meshe rreth orës 20:00 kur kishte ra terri i parë filloi procesioni me truporen e Zojës të shoqëruar me qirinjtë të ndezur, duke kënduar e lutur rruzaren. Procesioni mbaroi me adhurim me Shenjtueshmin Sakrament në Kishë. Vigjilja e sivjetme ishte shumë mbresëlënëse. Të jesh pjesëmarrës në këtë devocion, vërtet, është një përjetim i veçantë që bën të nxjerrësh zërin e lavdërimit e madhërimit për Zojën edhe kur zakonisht nuk ke vesh për këngë. Vargu i procesionit i ngjeshur me mijëra njerëz nëpër rrugicën përreth

kishës shenjtërore i përngjake njerëzimit në shtegtim kah amshimi, aty ku Nëna jonë qiellore lumturisht mbretëron me Birin e saj dhe na pret neve në përqa-fim.

Kulmi i gjithë festës ishte dita 15 gushti dhe mesha solemne e udhëhequr nga shkëlqesia e tij Imzot Dodë Gjergji, ipeshkvi ynë. Në pjesëmarrjen e mijëra besimtarëve të të gjitha viseve të Kosovës, shtegtarë nga vendet jashtë Kosovës, shumë komunitete tjera dhe me pjesëmarrjen e personaliteteve të shumta civile (kryetari i komunës së Vitisë z. Musa Misini, përfaqësues të zyryve ndërkombëtare) e ushtarake (Gjenerali i KFOR-it Roland Kater i shoqëruar me shumë ushtarë), me një ditë të bukur me diell ipeshkvi D. Gjergji, në bashkëcelebrim me ipeshkvin gjerman Josef Homayer, meshtarë kosovarë e kapelana të Kforit, e kremtoj meshën pontifikale në nder e lavd të Zojës Cërnaore. Mesha ishte një liturgji e përgatitur me përkushtim, që i ngjasonte një oaze hyjnore në tokë. Në një ambient të këndshëm pjerrësie i mbushur me gjelbërimin e verës, me pemë që krijojnë një kopsh të lehtë pushimi edhe trupor e me këngën e mrekullshme të korit të të gjitha famullive të Kosovës, gjithçka u shndërrua në

harmonia falendëreje, paqeje dhe dashurie. Aty ishin të pranishëm besimtarë të shumë gjuhëve, çka dëshmoi edhe leximi i ungjillit në 5 gjuhë të botës. Pasi pretku i Ipeshkvi, i cili ndër të tjera tha: “*Leximi i ungjillit në disa gjuhë të botës dëshmon se përmes dashurisë së Zotit mund të ndërtojmë pagën e vërtetë. Se Virgjëra Mari është ajo Nënë që i përkëmbet të gjithë si bijë dhe bija të veta. Kjo ditë na tregon të gjithëve se jemi të thirrur për të ngritur sytë ka qielli, sepse jeta jonë nuk mbaron këtu në tokë, se ajo nuk është e krijuar për asgjësim, e bjer-rje, por për jetën e amshuar. Për të arritur këtë qëllim kemi shembullin e Zojës së Bekuar, e cila e para e pranoi vullnësën e Zotit, që Ai të mos jetë një Zot i largët. Në këtë Nënë e përkohshmja u bë e amshueshme, jetë na u dhurua. Zoti nëpërmjet saj i afrohet botës, iu flet njerëzve. Atë dëshiron që kjo botë me njerëz dhe gjuhë të ndryshme të jetë vend i paqes. Ndërsa Krishti dëshiron të na jep dashurinë, e cila zemrat tona do t'i afëson për ta dashur Zotin dhe vëllain njeri. Në këtë vend të shenjtë të bashkuar nga vendet dhe në gjuhë të ndryshme, ta lejojmë Zotin për të na afësuar për të jetuar dhe punuar në paqe, si bijë dhe bijat e Tij dhe të Nënës sonë qiellore. Sot bota më tepër se kurrë ka nevojë për njerëz që dinë të jetojnë, bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë në paqe*



Procesioni në fillim të meshës

dhe dashuri. Ky është standardi që duhet plotësuar edhe në Kosovë, para çdo standardi tjetër. Kjo shenjtërore e jona e lashtë është oazë e

1950 u shpall dogmë, d.m.th. e vërtet e fesë, e Kishës Katolike, nga Papa Pio XII me Kush-tetuten apostolike "Munificen-tissimus Deus". Përbajtja e dog-mës është se Virgjëra Mari në mbarim të jetës së saj tokësore u ngrit në qiell me trup e me shpirt te Biri i saj Jezu Krishti. Edhe pse vetëm në vitin 1950 u shpall dogmë e Kishës Katolike, që do të thotë e vërtetë e obligueshme për të gjithë katolikët e botës, "Të ngriturit e Zojës...", si festë, ka një traditë të lashtë që nga shekujt e parë të Kishës. Kështu në Lindje festohet që nga shek. III, kurse në Perëndim depërton përmes Spanjës në shek. V. Shkrimet e para që kemi për këtë festë i gjejmë në shek. IV, nga Shën Efremi, atë i kishës siriane që thotë se trupi virgjëror i Marisë pas vdekjes nuk ju nënshtrua shkatërrimit. Mandej kemi shkrimin sirian

apo vetëm pjellë e traditës, kemi themelet në Shkrimin Shenjt, edhe pse jo të shumta, përkatësisht në Zbulesën e Shën Gjonit ku lexojmë "Në qiell u duk një shenjë e madhbërueshme: një Grua e veshur me diell, me bënë nën këmbë, në krye kezën me dymbdhjetë yje!" (Zb 12,1). Maria është e veshur me diell, me lavdi dhe shkëlqim hyjnor. Ajo është Gruaja mbi gjitha gratë. E denjë të bëhet mbretëresha e qiellit dhe tokës me kezë dymbdhjetë yjesh.



Truporja e Zojës Cërnaqore në Letnicë

ës në qiell" nagore në Letnicë

përshtetësisë, burim i pashtershmë i thirrjeve të shumta. Kjo shenjtërore u bë nxitja e shumë të rinjve e të reja për tu bërë mesharë dhe rregulltare të ipeshkvisë sonë, këtu ata gjetën frymëzim për t'u kushtuar Zotit dhe vëllait njeri. Por pa dyshim thirrja më e madhe që edhe Kishën edhe popullin tonë e ngriti në pedestalin më të lartë është e lumja Nënajonë Terezë, e cila pors ky qiri që e ndezëm mbrëmë, ndriçoi botën, dhe u shkri në dashuri ndaj Zotit dhe vëllait njeri. Në këtë shenjtërore të parët tanë kanë gjetur forcën dhe guximin për t'u martirizuar. Këtu edhe ne sot duhet të përtërbemi për të jetuar në paqe dhe dashuri. Uroj dhe lutem që dashurinë që Krishti e ka mbjellë në zemrat tona me anë të pagëzimit të rritet gjithnjë e më tepër e të konkretizohet në përditshmërinë tonë. Mos të frikësohemi prej Krishtit. Ai nuk i bën kujt keq. Ai asgjë nuk bën për interes të vetin. Gjithçka Ai bën, bën për të mirën tonë. E si mund dikush t'i frikësohet dashurisë, mirësisë, faljes, paqes. Lë t'i bashkojmë lutjet tona, jo vetëm për të mirat personale dhe familjare, por të lutemi edhe për Kishën dhe popullin tonë. Zoja Cërnaqore duke i pranuar lutjet tuaja na ndihmojtë për të ndërtuar një botë më të mirë për të gjithë, dhe duke jetuar dhe punuar në paqe dhe dashuri të bëmë edhe pjesëtarë të Mbrëtërisë qiellore, atje ku na pret Nënajonë qiellore."

E VËRTETË E FESË KATOLIKE

"Të ngriturit e Zojës në qiell me trup e me shpirt", më i nëntor

"Obsequia B. Virginis" që dëshmon të njëjtën të vërtetë. Për të ngriturit e Zojës në qiell flet edhe Shën Epifani, Timoteu i Jerusalemit, apokrifet të shumta të shekujve V dhe VI, më i njohuri "Transitus Mariae". Gjithashtu qysh në shekujt e parë u krijuan përkujtime dhe lutje liturgjike tek Kishat Lindore për ditën e vdekjes së Virgjërës Mari. Mbreti Maurici e caktoi me 15 gusht si datë e festës. Mandej kemi liturgjinë e Kishës Kopte, Kishës Etiopiane, Kishës Armene dhe Kishës jakobine siriane, të cilat e festojnë në të njëjtën datë, ndonëse disa prej këtyre kishave festën e quajnë me emërime të ndryshme, p.sh. "Vdekja e lavdishme e Marisë", "Ringjallja e Marisë", por të gjitha emërtimet e kanë për qëllim të njëjtën njëmendësi të fesë, përkatësisht Virgjërës Mari. Më vonë në historinë e mendimit teologjik, në shekujt VI deri në X do të gjejmë shumë dëshmi tjera, nga shumë teologë e shkrimtarë të kishës edhe në Lindje edhe në Perëndim. Këto pak të dhënë dëshmojnë për traditën e lashtë e të bujshme të kishës që nuk ka pushuar deri në ditët tona, madje është përcjell me përshtetësi të çmueshme që sot kisha i mbanë si dëshmi të kohërave të një feje të gjallë gjithandëj botës për Virgjërën Mari. Për gjithë këto përsiatje, që nuk mund të konsiderohen ide të krerve kishtar të shekujve të hershëm a të vonshëm

TRUPORJA MREKULLIBËRËSE E ZOJËS CËRNAQORE

Shenjtëroreja e Letnicës u bë e njohur për shkak të Truporës së Zojës, e cila sipas gojëdhënave të shumta kishte ikur nga kisha e Shkupit, pas dëgjies së kishës së saj prej turqve, përndjekjeve dhe torturimeve të tmerrshme të të krishterëve, për tu gjetur mrekullisht në një pemë në Letnicë aty ky është sot kisha. Për një kohë të gjatë besimtarët ishin lutur aty e më pas kishin vendosur të ndërtonin një kishë për nder të saj. Që atëherë nuk pushojnë së shtegtuari mijëra e mijëra njerëz nga të gjitha viset tona. Kemi dëshmi të shumta se para kësaj Trupore të Zojës, kanë nodhur mrekulli, janë plotësuar dëshira dhe lutje të shumta. Para saj shumë shtegëtarë kanë gjetur Nënë, që i plotëson lutet e tyre dhe janë kthyer në vendet e veta me qetësi shpirtërore, të penduar, madje edhe me kthim kah Jezu Krishti.

Truporja është e punuar nga druri, besohet të jetë nga druri i blinit. Truporja e paraqet Zojën të ulur. Dora e djathtë e Zojës pushon në prehrin e saj dhe mbanë një mollë. Kurse në dorën e majtë mbanë Jezusin fëmijë. Është e veshur me veshje solemne, të çmueshme vezuluese, që përvejt ndërrohet. Truporja qëndron mbi altarin kryesor në presbiter. Nuk ka të dhëna se kush e ka punuar truporen.

Përgatiti:

Don Fatmir KOLIQI



Imzot Dodë Gjergji dhe Naim Tërnavë gjatë nënshkrimit të memorandumit

U NËNSHKRUAR MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT MES IPESHKVISË SË KOSOVËS DHE BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Më 11 korrik 2007, në Prishtinë, në ambientet e Universitetit Amerikan, u nënshkrua memorandum i mirëkuptimit në mes të Ipeshkvisë së Kosovës dhe Bashkësisë Islame të Kosovës, përkatësisht, të Imzot Dodë Gjergji dhe Naim Tërnavës, kundër trafikimit me qenie njerëzore. Ky nënshkrim po të njëjtën ditë i hapi rrugë mbajtjes së punëtorisë dyditore (11 dhe 12 korrik) po me të njëjtën temë: Partneriteti kundër trafikimit me qenie njerëzore. Në këtë punëtori, pos përfaqësuesve të të dyja religjioneve, islama dhe katolike, morën pjesë dhe ligjërues edhe përfaqësuesit e Shërbimit Policor të Kosovës, Zyra për Qeverisje të Mirë, Ministria e Drejtësisë, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Pa dyshim se ishte një takim historik, pasi që për herë të parë në Kosovë, morën pjesë së bashku priftërinj dhe imamë, motra të nderit dhe zonja të ngarkuara me veprimtari fetare në Bashkësinë islame.



Motra Linditë gjatë paraqitjes së kushteve të përjetshme

KUSHTET E PËRJETSHME TË MOTËR LINDITA SPAQI

Në Prizren, në Famullinë e "Zojës Ndhimëtare", më 19 gusht 2007 motër Lindita Spaqi, bijë e kësaj familje, e Motrave Engjëlllore të Shën Palit, i pranoi Kushtet e Përfjetshme.

Mëshën e udhëhoqi ipeshkvi ynë, Imzot Dodë Gjergji në bashkëmëshim me don Agim Qerkinin dhe P. Lovro Govran. Në meshë ishin të pranishme shumë motra Engjëlllore që kishin ardhur nga Shqipëria dhe Italia. Duhet theksuar praninë e Motrës Epurë të Motrave Engjëlllore të Shën Palit, Motër Nur-Elaine Anaissi me prejardhje braziliane, në duart e së cilës motër Lindita i paraqiti Kushtet e Përfjetshme. Gjithashtu, e pranishme ishte M. Bianca Marascchi, përgjegjëse e noviciatit. Në meshë ishin të pranishëm edhe familja e motrës Lindita dhe një numër i madh i besimtarëve të Prizrenit dhe të Grahdanikut.

Kjo ditë ishte vërtet shumë e bukur, mesha ishte shumë solemne dhe e përgatitur mirë. Ndihej një atmosferë shumë e qetë dhe e gëzueshme, e përjetuar shumë nga të gjithë. Poashtu, duhet theksuar se kori i katedrales me këndimin e tyre madhështor ia shtoi bukurinë kësaj feste, si dhe melodrama "Dhjetë virgjërat" e përgatitur me këtë rast nga të rinjtë e famullisë. Këtyrë gëzimi të madh të Motrave Engjëlllore iu bashkangjit edhe një gëzim tjetër, kur më 23 gusht 2007, ditën e Festës Virgjëra Mari Mbretëreshë e Qiellit dhe e Tokës, tri Postullantet tona: Berlinda Milici, Amanda Shkoka dhe Leonora Ndreca filluan Noviciatin. Falënderojmë Zotin për këto ditë gëzimi dhe hiri që ua dhuroi motrave Engjëlllore dhe njëkohësisht Kishës së tij. URIME!

Një Kishë e martirizuar, por e gjallë dhe vepruese

Koment i shkurtër mbi Letrën e Papës dërguar popullit kinez

■ SHKRUAN:
Don Anton UKAJ

Kërkesa për normalizimin e marrëdhënieve mes Vatikanit dhe Kinës, gatishmëria për dialog, situata e Kishës në Kinë, liria religjioze dhe mundësia e hapjes të një Nunciature apostolike në Pekin, janë tema që e dominojnë më së shumti letrën që para disa ditësh ka publikuar dhe dërguar Papa popullit dhe kishës në Kinë.

Në këtë letër që Papa ia dërgon ipeshkvijve, meshtarëve, rregulltarëve, rregulltareve dhe laikëve të Kishës katolike në Republikën Popullore të Kinës, përsëritet shpesh situata e rëndë dhe persekutimet që vazhdimisht iu bëhen Kishës në Kinë. Por, qysh në fillim duhet të theksohet se ky dokument nuk përmban as një direktivë politike, por është një direktivë përplot me sugjerime religjioze dhe humane. Pra, nuk është një dokument politik. Kështu shpjegohet edhe nga deklarimet që na vijnë nga Vatikan: "Nuk është një dokument politik e as nuk dëshiron të jetë një akt akuze kundër autoriteteve qeverisëse".

Testi që përmban diku rreth 50 fletë dhe që është përkthyer në disa gjuhë të huaja, lirisht mund të ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë Ati i Shenjtë flet mbi situatën e Kishës atje dhe mbi aspektet teologjike, ndërsa në pjesën e dytë ndalet më shumë mbi direktivat e jetës pastorale.

Dokumenti hapet me një citim të Letrës të Shën Palit drejtuar bashkësisë të Kolosianëve: "Të dashur bashkëvëllezër ipeshkvij, të dashur meshtarë, të dashur rregulltarë dhe të dashur besimtarë të Kishës katolike në Kinë... nuk pushojmë duke u lutur për ju". "Ju e dini mirë se sa jeni të pranishëm në zemrën time dhe në lutjen time të përditshme dhe sa është e thellë lidhja e bashkimit që na bashkon shpirtërisht".

Benedikti i XVI i shpreh afërsi vëllazërore ndaj popullit kinez duke mos lënë anash preokupimin e tij të thellë për disa aspekte të rëndësishme për jetën kishtare të këtij vendi. Papa nuk pretendon të trajtojë çdo aspekt të problematikave shumë komplekse të Kishës atje, por, siç thamë edhe më parë, dëshiron t'ia japë disa direktiva jetës së

Kishës dhe veprës ungjilëzuese në Kinë. Direktiva që arrijnë, siç shpjegon salla e shtypit në Vatikan, janë "një përgjigje kërkesave dhe problematikave të shumta të ardhura në vitet e fundit në adresën e Papës".

Dialogu dhe normalizimi i relacioneve

Në letër shihet qartë se si Papa ia shtrin dorën Pekinit dhe thërrret për normalizimin e lidhjeve diplomatike mes Vatikanit dhe Kinës. "Jam i vetëdijshëm që normalizimi i lidhjeve me Republikën Popullore të Kinës kërkon kohë dhe vullnet të mirë nga të dy palët. Nga ana e vet, Selia Shenjte mbetet gjithmonë e hapur në dialog, dialog ky shumë i nevojshëm për të kalimin e situatës së rëndë që edhe sot e kësaj dite po dominon".

Benedikti XVI nënvizon se si kjo situatë e rëndë e keqkuptimeve dhe e moskuptimeve nuk i gëzon as autoritetet kineze e as Kishën katolike në Kinë. Është kjo pjesa kryesore e dokumentit, një porosi e qartë bërë autoriteteve civile.

Toni i letërës është për një hapje në dialog: Papa eviton vrapimet drejt tensioneve dhe përlëshjeve, riafirmojnë gatishmërinë e Selisë Shenjte që ta ndjekë dialogun me autoritetet kineze. Në të njëjtën kohë thekson shumë herë që bashkësia katolike kineze jeton në rrethana vërtet të vështira. Papa e definon si detyrë intime dhe të pashmangshme nevojën e konfirmimit në fe të katolikëve kinezë dhe favorizon bashkimin e tyre.

Raportet Kishë-Shtet

Asnjë ndërhyrje e Kishës në çështjet politike, por theksim nga ana e Papës mbi lirinë religjioze dhe mbi përgjegjësitë e sajë pastorale. Raporti mes Kishës dhe Shtetit në Kinë është njëra ndër dy pikët tensionuese që pengojnë ndreqjen e relacioneve diplomatike. "Le ta dijë Kina – duket se është kah thërrret Papa – Kisha katolike dëshiron të ofrojë një shërbim të përvuajtur dhe të painteres, në atë që i takon, për të mirën e katolikëve kinezë dhe për të mirën e tërë popullatës kineze".

Papa rikthehet shumë herë mbi këtë argument, kërkon të



evitojë keqkuptimet dhe është i qartë: "Kisha në Kinë e ka misionin jo të ndërrojë strukturën apo administrimin e Shtetit, mirëpo t'ua shpallë njerëzve Krishtin". Dhe ja këtu duket të nxjerrë në pah Enciklikën Deus caritas est: "Kisha nuk mundet dhe nuk duhet të vihet në vend të shtetit. Por nuk mundet dhe nuk duhet as të qëndrojë larg në 'luftën' për drejtësi". Papa kërkon të tejkalohet konflikti permanent me autoritetet legjitime civile dhe në të njëjtën kohë duket të mos pranojë një butësi ndaj atyre, kur ato ndërhyjnë padrejtësisht në materien që ka të bëjë me fenë dhe disiplinën e Kishës. "Rinovoj urimin që, gjatë dialogut të respektueshëm dhe të hapur mes Selisë së Shenjte dhe ipeshkvijve kinez, nga njëra anë, dhe autoritetet

Numri i katolikëve në Kinë

Ekzistojnë rreth 8 deri në 12 milionë katolikë në Kinë, me popullsi mbi rreth 1 miliard e 300 milionë banorë; 145 qarqe kishtare dhe më shumë se 200 ipeshkvij, nga të cilët 60% ka më shumë se 80 vjet; 3,200 meshtarë, 156 bashkësi rregulltare, 6,000 rregulltarë, 2,300 seminaristë dhe 30 seminarë.

qeverisëse nga tjetra, të mund të tejkalohen vështirësitë e cekura dhe kështu t'i vijë në ndihmë një kuptimi të mirë që do të jetë në avantazh të bashkësisë katolike dhe të bashkëjetesës sociale".

Një Kishë e vetme në Kinë

"Kishë katolike në Kinë, grigjë e vogël e pranishme dhe vepruese në hapësirën e një populli të madh që ecën në histori... Mos ke frikë". Papa nuk citon as një herë shprehjen "Kishë patriotike", por thekson Primatin pjetror dhe universalitetin e Kishës. "Ipeshkvi

Shprehim

教宗致中華人民共和國內
主教、司鐸、度獻身生活者、

藉著今天發表的這封信，教宗本篤十六世希望充
會團體的愛與關懷。

教宗的文件中突出顯示了兩個基本的態度：一方
全體天主教友的深厚感情、對中國人民的友好敬意；
會學領域中的偉大公教傳統以及梵二大公會議亙古不
情地邀請人們致力於愛德、合一與真理。

這封信是寫給在中國的教會的；涉及的首要
以來中國主教和司鐸們向聖座提出的問題。為此，這
意成為指責政府的訴狀。同時，不能無視教會在中國
困難。

教宗談到了基督建立教會：授予宗徒們及他們
劃。在此指引下，教宗充分考慮到了五十年來在中國
種問題。並從這一計劃中汲取了啓示和指導，從而
對和解決上述問題。

信中，教宗本篤十六世表示完全願意同民事當局
最終找到解決有關公教團體的各種問題的辦法。從而
華人民共和國之間的關係正常化，確信天主教徒，在
作出生活見證之際，作為好公民，也為中國人民的福

二〇〇七年六月三十日

– afirmon në letër – është fillimi dhe fondamenti i pashëm i bashkimit në Kishën partikulare", por "në çdo Kishë partikulare duhet të jetë i pranishëm autoriteti suprem i Kishës". Benedikti XVI flet për një Kishë të vetme katolike-universale. Pikërisht për këtë e tërë Kishë që është në Kinë është e thirrur ta jetoj dhe ta tregoj këtë unitet-bashkim në një bashkim shpirtëror shumë më të pasur që të rritet edhe në një bashkim harmonik hierarkik. Papa lajmëron: "Ekziston një situatë e dhimbshme dhe me kontraste të forta dhe mes çështjeve të ndryshme është roli domethënës i zhvilluar nga organizma, të cilët janë vënë si përgjegjës kryesorë të jetës së bashkësisë katolike".

Papa e definon Shoqatën Patriotike "autoritet civil". Por shpjegon: "Nuk janë autoritetet civile struktura të Kishës. Kisha e ka një strukturë të veten, që është ajo e trashëgimisë apostolike, të cilës i takon përgjegjësia të garantojë qëndrimin e Kishës në të vërtetë". Si dhe: "pretendimi i shtetit për ekzistencën e disa organizmave dhe të panjohura në strukturën e Kishës, e të vihen mbi vetë ipeshkvijtë dhe ta udhëheqin jetën e bashkësisë kishtare – thotë Papa – nuk i përgjigjet doktrinës katolike".

Emërimi i Ipeshkvijve

Është kjo një ndër nyjat në lidhjet mes Vatikanit dhe Pekinit. Një shugurim ipeshkvor pa mandatin e Papës paraqet një plagë të dhimbshme në bashkimin kishtar dhe një shkelje të rëndë të disiplinës kanonike. Benedikti XVI i referohet Kodeksit të së Drejtës kanonike që stabilizon sanksionime të rënda si për ipeshkvin që jep me liri shugurimin ipeshkvor pa dërgimin apostolik, si për ipeshkvin që pranon shugurimin. Shugurimi i paligjshëm, specifikon Papa, paraqet një plagë të rëndë që ju bëhet Kishës.

Papa, në këtë rast, nuk paraqet një autoritet politik që përzihet pa nevojë në gjërat e brendshme të shtetit dhe e cenon sovranitetin. Selia Shenjte do të donte që të jetë një liri e plotë në emërimin e ipeshkvijve, dhe pikërisht për këtë arsye dëshiron të gjendet një marrëveshje me Qeverinë për të zgjedhur disa çështje për sa i përket zgjedhjes së kandidatëve për ipeshkvë, publikimin e emërimeve si dhe rinjohjen e ipeshkvijve të ri nga ana e autoriteteve civile.

Ipeshkvij të paligjshëm: klandestiniteti nuk është normalitet

Klandestiniteti nuk hyn në normalitetin e jetës së Kishës. Papa i ndan çështjet e ndryshme: disa ipeshkvij janë "të kushtëzuar të

友友

卜展示他對在中國的天主教

前，是在精神上對在中國的
弓一方面，是在強烈呼吁教
變的原則。為此，這是在熱友問題：明確地回答了長期
无不是政治性的文件，更無
天都要面對的衆所周知的的繼承人主教們的0最初計
劃的教會生活中所面臨的各
卜著共融、真理的精神來應更開平靜而建設性的對話，
『現我們所期盼的聖座與中
能夠自由宣信信仰、慷慨地
社作出貢獻。

shugurohen fshehtazi". Në këto raste Selia Shenjete bën thirrje që këta barinj legjitimë të rinjohen si të tillë edhe nga autoritetet qeverisëse dhe për efektet civile.

Pastaj janë ipeshkvij që nën shtytjen e rrethanave partikulare janë pajtuar që ta pranojnë shugurimin ipeshkvor pa mandatin e Papës por pastaj, kanë kërkuar që të kenë mundësi të pranohen në bashkim me pasardhësin e Pjetrit. Në këto raste Papa u ka lejuar atyre legjitimitetin e plotë në ushtrimin e detyrës ipeshkvore.

Megjithatë, është e domosdoshme që ipeshkvijtë e legjitimuar të vënë gjithnjë e më shumë qëndrime të prera në bashkim të plotë me pasardhësin e Pjetrit. Në fund, nuk mungojnë disa ipeshkvij, në një numër shumë të vogël, që janë shuguruar pa mandatin e Papës dhe nuk kanë kërkuar, dhe ende nuk kanë pranuar, legjitimitetin e nevojshëm. Ata – thotë Papa – duhet të konsiderohen të paligjshëm, por vlefshmërisht të shuguruar. Nuk janë në bashkim me Papën, por e ushtrojnë në mënyrë të vlefshme detyrën e tyre në administrimin e sakramenteve, edhe pse në mënyrë të paligjshme. Çfarë pasurie shpirtërore do të buronte për Kishën në Kinë, nëse në praninë të kushteve të nevojshme – përfundon Benedikti XVI – edhe këta barinj do t'i

vinin para bashkimit me Papën dhe me të gjithë ipeshkvijtë katolikë.

Të garantohet liria e vërtetë fetare

Në radhë të shumta të letrës, Papa kërkon të garantohet një liri e vërtetë religjioze. "Kisha i kërkon Shtetit t'iu garantojë qytetarëve katolikë ushtrimin e plotë të fesë së tyre në respektin e një lirie të plotë, të qëndrueshme dhe të vërtetë fetare".

Pak rreshta më vonë Papa kërkon që të gjithë besimtarët të kenë mundësi ta shprehin lirisht fenë e tyre në kontekstin social në të cilin gjinden. Dhe pak më tutje, në pjesën e dytë të tekstit, Papa nënvizon që "në vitet e fundit Kisha gëzon, në krahasim me të kaluarën, liri më të madhe fetare. Megjithatë, nuk mund të mohohet fakti i mbetjes së kufizimeve të shumta dhe të rënda që e prekin zemrën e fesë dhe që, në një mënyrë, ia zënë frymën aktiviteteve pastorale".

Papa vë në pah që Kisha në Kinë vuan për problemet me të cilat është d'uke u ballafaquar për t'i tejkaluar, në brendinë e vet dhe në lidhjet e saja me shoqërinë civile kineze, tensione, ndarje dhe përçarje. Përkishtë për këtë, në letër, kërkon nga të gjithë katolikët dialog, mirëkuptim, falje në qoftë se është nevojja dhe një udhëtim serioz drejt një bashkimi të plotë. Dhe shton: "Të gjithë jemi të vetëdijshëm për faktin se ky udhëtim nuk mund të realizohet në një kohë shumë të shpejtë, por jemi të bindur se Kisha mbarë do ta ngritë një lutje për një qëllim të tillë".

Kisha katolike e SHBA-s e ndihmon Kishën në Afrikë

Kisha Katolike në SHBA i ka dhuruar gjatë muajit korrik Fondit të Solidaritetit për Kishën në Afrikë shumën prej 628 mijë dollarë për formimin e kandidatëve meshtarakë, për edukimin katolik, për katekezë dhe për mjetet e informimit shoqëror. Sipas agjencisë Fides, mjetet financiare do t'u jepen Ganes për projektin e arsimimit të të rinjve; Malavias për mësues të katekezës dhe për të rinj; Ruandës për pajisjen me libra katekistike; Sudanit për vepërimitar pastoral dhe Zimbabves për arsimimin e mësuesve të katekezës. Ipeshkvi John Huston Ricard, kryetari i komitetit për Kishën në Afrikë, përkritazi për këtë ndihmë solidariteti thotë: "Kisha në Afrikë është pjesë e Kishës së përgjithshme, e cila po e përjeton një rritje të shpejtë, prandaj asaj i nevojiten mjetet dhe përkrahja e familjes/bashkësisë sonë. Pasuria e saj shpirtërore fatkeqësisht lidhet me varfërinë e saj materiale." Fondin Pastoral për Nevojat e Kishës në Afrikë e kanë themeluar ipeshkvijtë

Krishterimi në Kinë



Matteo Ricci (1552-1610), jezuit, apostull i Kinës.

Fillet e krishterimit tek populli kinez datojnë në shek. VII. Të parët misionarë ishin nestorianët dhe kisha asiriane, gjurmët e së cilën i gjejmë në Xi'an. Ky mision nuk kishte pasur sukses të madh. Kur Tang Wu Zong i kishte larguar të gjitha religjionet e ardhura, krishterimi gati se u shua. Kisha kishte mbijetuar tek Ujgurët, kurse do të përfjetojë ripërtëritjen tek mongolët gjatë dinastisë së Yuan. Po ashtu, sipas gjurmimeve të fundit konstatohet se krishterimi ishte i pranishëm në Tibet që në shek. VI e VII.

Ungjillëzimi i dytë në Kinë do të jetë pak më i suksesshëm në shek. 13, me françeskanin Gjon Montecorvino i cili kishte arritur deri në Pekin. Treqind vjet më vonë Shen Fran Ksaveri, një ndër misionarët më të mëdhenj të Lindjes, vdes në kufirin kinez. Por një ndër misionarët më të suksesshëm në Kinë ka qenë jezuiti Matteo Ricci (1552-1610), i quajtur edhe apostull i Kinës. Ai njihte gjuhën kineze, shkruante libra dhe ligjëronte shkencat natyrore, matematikën dhe gjeografinë, e përmes tyre edhe krishterimin. Kjo popullit kinez i pëlqente pa masë sa që arriti të bëhet njeri me famë. Me një intuitë prej shkencëtari M. Ricci hetoi se misioni i vetëm i vërtetë duhet të jetë metoda e inkulturimit. Kinezët e konsiderojnë njeriun më të dijshtëm të huaj që ka shkëlur në Kinë. E quajnë edhe Li Madou, e vizitojnë varrin e tij dhe është i përfshirë në enciklopedinë kineze.

Që nga viti 1958 regjimi maoist e vë në kontroll Kishën katolike duke ia imponuar zgjedhjen e ipeshkvijve dhe themelon të a.q. "Bashkimin patriotik të katolikëve kinezë", e konsideruar si kishë e ndarë nga Selia e Shenjtë, përkundër "Kishës së nëndheshme" apo të Fshehtë e që janë ata katolikë që nuk i janë nënshtruar këtij regjimi. Kisha e fshehtë jeton fenë në klandestinitet dhe jeta e saj vuan përherë persekutimet e vazhdueshme. Tentimet e njëpasnjëshme të Vatikanit për të pasur marrëdhënie diplomatike dhe pastorale kanë qenë të pasuksesshme. Letra e Papës Benedikt XVI është një tentativë e re e rigjetjes së metodës për të pasur një marrëdhënie të shëndoshë mes Republikës Popullore Kineze dhe Vatikanit me qëllim të ushtrimit të lirë të fesë katolike.

Lajme shkurt

amerikanë në vitin 2004 dhe që atëherë ky fond është bërë krah i Kishës në Afrikë.

Çmim prestigjioz për Atë F. Lombardi

Atë Frederiko Lombardi, udhëheqës i Sallës së Shtypit të Selisë së Shenjtë dhe drejtori i Radio Vatikanit është fitues i çmimit të sivjetmë "Angelo Narducci" që u jepet njerëzve për punën e tyre të suksesshme në sferën e kulturës, në gazetari dhe në mjetet tjera të komunikimit shoqëror.

Shenjtërorja e Zojës Ndhimëtare She Shan në Kinë vizitohet nga të rinjtë e shumtë kinezë

Shenjtërorja kineze She Shan, e kushtuar Virgjërës Mari, Zojës Ndhimëtare, gjithnjë e më tepër po vizitohet nga shtetgarë të shumtë. Kryesisht shtetgarë më të shpeshtë janë të rinjtë kinezë nga gjithë vendet e Kinës, që gjatë pushimeve verore vizitojnë Shenjtëroren e njohur. Në mënyrë të veçantë shtetgarët janë shtuar pas Letrës së Papës drej-

tuar katolikëve kinezë. Kjo shenjtërore është një shenjë se Kisha në Kinë po ungjillëzohet dhe po rriten shpresat rreth bashkimit të katolikëve kinezë. Një meshtar kinez përmes disa agjencive të lajmeve në web faqe ka theksuar se katolikët kinezë janë të drejtuar në këtë shenjtërore për ta lutur Zojën Ndhimëtare në shenjtëroren She Shan, që ta përkëdhelë kishën në Kinë, që ajo të arrijë sa më shpejt bashkimin e saj.

250 milionë të krishterë të persekutuar

Gjatë viti 2007 po përfjetojnë persekutimet rreth 250 milionë të krishterë për shkak të besimit të tyre në Jezu Krishtin. Ky është mendimi i organizatës "Release International" me qendër në Britaninë e Madhe.

Pas një vëzhgimi nëpër botë të pozitës së të krishterëve dhe persekutimeve të tyre, RI zbulon se personat persekutohen vetëm se besojnë në Krishtin, një gjen-dhe kjo e pranishme, në mënyrë të veçantë në botën islame. Përveç kësaj, e njëjta organizatë nënvizon edhe tri zona perseku-

timi: botën komuniste, hinduiste dhe budiste.

Keqtrajtimet e të krishterëve që i përfjetojnë në këto zona – sipas RI – manifestohen në mënyra të ndryshme, siç janë: konvertimet e dhunshme, dhunimi i kishave, tortura, dhuna, dje-gia e të mirave tokësore/materiale, burgosja dhe ekzekutimet. Fatkeqësisht as qeveritë e botës islame nuk ia arrijnë t'i mbrojnë të drejtat e pakicës së krishterë, thekson i njëjtë burim.

Emërohet Nunci Apostolik në Emiratet e Bashkuara Arabe

Selia e Shenjtë për herë të parë emëron Nuncin Apostolik në Emiratet e Bashkuara Arabe, arqipeshkvin Mouned El-Hachem. Këtë lajm e bëri të ditur Salla e Vatikanit për informim të shtunën më 04 gusht 2007. Marrëdhëniet diplomatike mes dy shteteve ishin arritur të lidhen në muajin maj të këtij viti. Nunci i ri është nga Libani. Që nga viti 2005 ai ka kryer detyrën e delegatit të Papës në Kuvajt, Jemen, Bahrain dhe Katar.

Dukuria e së shenjtës dhe r

Pandehmat e para mbi të shenjtën në religjion kanë buruar nga krabarori i etnologjisë dhe sociologjisë dhe janë mbështetur kryesisht në dy themele: “mana” dhe “totemi”. Mana është vështruar si një fuqi impersonale dhe anonime e pranishme në klan dhe në secilin anëtar të klanit, fuqi kjo e cila përbënte qendrën e të gjitha dukurive religjioze. Totemi shpreh dhe simbolizon mana-n. Totemi, sipas kësaj është hipostaza e klanit. Mana është krabarori i të shenjtës dhe gjendet në zanafillën e religjionit primitiv. Teoria sociologjike e të shenjtës rrënjët e veta i lëshon pikërisht në këtë fushë të kërkimeve etnologjike mbi manën dhe totemin. E ndikuar edhe nga rryma e evolucionizmit, kjo teori është zhvilluar deri në ditët tona, në interpretimet e ndryshme të autorëve që ndjekin këtë shkollë të interpretimit sociologjik të religjionit. Këtu do të paraqesim disa autorë të kësaj rryme duke shkëputur disa nga teoritë e tyre themelore rreth këtij argumenti.

■ SHKRUAN:
Don Robert KOLA

Nga sociologjia e së shenjtës në antropologjinë religjioze.

E. Durkheim: e shenja dhe shoqëria

E. Durkheim (1858 - 1917), njëri prej themeluesve të vëzhgimeve sociologjike mbi dukurinë e së shenjtës në religjion, mbante qëndrimin se manifestimi religjioz është vetëm shprehje e aktivitetit natyror të njeriut. Në vëzhgimet e tij mbi religjionin, ai përjashtonte të mbinatyrshmen, misterin dhe hyjnoren dhe vëzhgonte mitet, ritet dhe formimin e bashkësisë shoqërore. I mahnitur nga zbulimet e Darwinit mbi zanafillën dhe evolucionin e llojeve, rimerr skemën dhe metodën nga paleontologjia dhe i qaset zanafillës së religjionit. Studimet e tij mbi religjionet australiane e çojnë tek totemizmi, ku, sipas tij, është forma e parë e religjionit, e cila strukturohej duke u nisur nga një fuqi impersonale dhe anonime, që thirrej mana e pranishme në secilin anëtar të klanit. Mana sipas tij është materia e parë e religjionit zanafillës, e cila gjatë rrathëve të evolucionit ka kaluar në sfera me të ngritura në të gjitha religjionet historike.

Sipas këtij studiuesi, duke vëzhguar vetëdijen kolektive të shoqërisë, hetoi se si kjo vetëdije mbizotëron mbi atë individuale, dhe kjo vetëdije sipas tij hyjnzon shoqërinë. E shenja sipas tij është kategori sociologjike dhe kolektive, është magjia e cila ruan ndjesitë e grupit, është elementi i kohezionit të grupit. Pra, është shoqëria ajo që në njeriun e zgjon në rëmbim për hyjnoren. Veprimi kolektiv i klanit zbulon domethënien e krijimit të kultit, riteve, dhe sjelljeve të tjera praktike, me një fjalë zbulon qëndrimin e njeriut ndaj të shenjtës.

Durkheimi do të këtë ndikim të madh në këtë fushë, ku e shenja do të jetë e mbyllur për shumë kohë vetëm e vetëm në fushën sociologjike, dhe vetëm duke u nisur nga kjo fushë, synohet të analizohet dukuria e shenjtës në religjion.

Funksionet shoqërore të së shenjtës: domethënia e “manës”

M. Mauss (1873 - 1950) dhe H. Hubert (1872 - 1927)

Durkheimi vëzhgimin e tij mbi të shenjtën e kishte përqendruar mbi fuqinë kolektive, e cila buronte nga shoqëria dhe e cila përbënte boshlin e saj thelbësor të organizimit. Këtë botëkuptim të tij mbi religjionin do ta spikasë edhe më tepër nipi i tij M. Mauss, i cili së bashku me H. Hubertin, do të studiojnë rolin e së shenjtës në shoqëri, sipas pikëpamjeve të mësuesit të tyre.

Maussi në totem heton fshehtësinë e së shenjtës, mbasi aty bashkohen dhe njëmendësohen ndjesitë e kolektivit që kanë për qëllim t'i dhurojnë secilit anëtar të klanit atë fuqi, e cila tejkalon botën e tyre individuale. Duke qenë se totemi është i shenjtë, ai rrethohet me urdhra dhe cilësohet si ajo më e rëndësishmja. Më tepër se Durkheimi, Maussi përqendrohet në simbolizëm. Në sytë e tij e shenja është e përqendruar në simbol. Për këtë arsye totemi është simbol i grupit, i cili simbolizon pra të shenjtën. Arsyeja është e thjeshtë: e shenja buron nga ndjesia e grupit dhe është e përbërë nga ndjesitë e përbashkëta, të cilat janë të përqendruara në totem. Fuqia e cila shpërthen nga vetëdija kolektive e grupit, pra, e shenja e simbolizuar nga totemi, bëhet shpirti i religjionit; nën simbolin e totemit, ajo është në të njëjtën kohë objekt i kultit dhe elementi qendror i kohezionit shoqëror.

Sipas Mauss-it, mana në të njëjtën kohë është forcë e një qenie, është një cilësi, është një veprim dhe është një gjendje, mu ashtu siç ka konotacione të ndryshme edhe në gjuhën maleziane nocioni mana, i cili është edhe mbiemër edhe përemër edhe folje.

Përderisa Durkheimi e kufizonte manën vetëm në religjionet totemike, Maussi dhe Huberti synojnë që manën ta hetojnë edhe në religjionet tjera, duke ia veshur kështu kësaj dukurie një karakter universal.

Pranishmëria e manës në religjionet tjera

Sipas këtyre dy studiuesve, dukuria e manës hetohet jo vetëm në të gjitha religjionet primitive që kishin një karakter totemik, por kjo dukuri hetohet edhe në religjionet e Librit. Sipas tyre nocioni fundamental brahma që spikat religjionin hindus, mbërthente në vete dhe ripërtërin manën, si në Librin e Vedave po ashtu dhe në atë të Upanishadës. Këto tekste me nocionin brahma nënkuptojnë lutjen, rëmbimin,

ritin si dhe pushtetin religjioz. Meshtari në këto religjione e bart gjithashtu emrin Brahman. Kasta brahmanike është kasta e së shenjtës. Brahmani është lidhja përmes të cilit veprojnë njerëzit dhe hyjnitë. Brahmani është njëmendësia, ndërsa gjerat tjera janë iluzion. Ky është principi i parë i animuar nga Universi. Mbi këtë princip themelohet yoga. Këta autorë jo vetëm që hetuan në Indi dukurinë e fshehur të manës në nocionet e religjionit hindus, por do të kërkojnë që edhe në Greg-

inë e vjetër të hetojnë dukurinë e manës të mbështjellë me një mendësi tjetër që shprehet përmes kategorive të këtij nënqielli.

Nocionet *physis* dhe *dynamis* në religjionin grek, paraqesin në të njëjtën kohë substancën materiale dhe forcën shpirtërore të dukurisë religjioze dhe këtyre dukurive iu mveshën edhe trajtat personale të vetive të njeriut në qeniet hyjnore. Kjo dukuri nuk është gjë tjetër, sipas këtyre studiuesve, veçse shprehja e manës dhe totemit sikur në religjionet primitive.



Shpyllë totemike në Alaskë

eligjioni (2)

“E shenja është e përqendruar në simbol. Për këtë arsye totemi është simbol i grupit, i cili simbolizon pra të shenjtën. Arsyeja është e thjeshtë: e shenja buron nga ndjesia e grupit dhe është e përbërë nga ndjesitë e përbashkëta, të cilat janë të përqendruara në totem. Fuqia e cila shpërthen nga vetëdija kolektive e grupit, pra, e shenja e simbolizuar nga totemi, bëhet shpirti i religjionit; nën simbolin e totemit, ajo është në të njëjtën kohë objekt i kultit dhe elementi qëndror i kohezionit shoqëror.”

M. MAUSS

Mbasi pra, këta dy autorë ia dolën, sipas qasjes se tyre, të hetojnë identitetin e manës me të shenjtën, nuk iu mbetej tjetër pos të hetonin edhe identitetin në mes të shenjtës dhe shoqërisë. Maussi dhe kolegu i tij e thonë pa hezitim këtë identitet në mes të shenjtës dhe shoqërisë: “Çka është e shenja, pyesnin ata, dhe shtonin, gjërat e shenja janë gjëra shoqërore. Mirëpo, ne dëshirojmë të shkojmë edhe më larg. Sipas gjykimit tonë e shenja është gjithë ajo që për grupin dhe anëtarët e tij e përcaktojnë rendin e shoqërisë”.

Në sytë e tyre, shkenca shoqërore ka bërë të mundur të hetojë dhe të kthjellojë dukuritë religjioze, mbasi kjo shkencë ia doli ta nxjerrë në dritë se si hyjnitë, në çastet e duhura, lëshonin tempujt e tyre për t'u bërë gati vendin dhe iu bënë vendin për gjërat njerëzore dhe ato shoqërore, siç ishin: atdheu, prona, puna dhe personi i njeriut. Strumbullari rreth të cilit përqendrohen të gjitha mitet, ritet, doket, është e shenja që është qendra e secilës

dukuri religjioze, përfundojnë këta dy studiues.

Një interpretim i ri i manës dhe i së shenjtës sipas L. Levi Makarius

Në studimet e saja etnografike, studiuesja L. L. Makarius jep një interpretim të ri sociologjik mbi manën dhe të shenjtën në religjionet primitive. Sipas analizave të saj, në shoqëritë etnologjike tabuja e gjakut është përbërësja e rendit shoqëror. Përvetësimi magjik i gjakut, incesti dhe vrasja, sidomos vrasja në farestsi, janë tri mjetet e shkëlqes se tabusë. Kjo shkëlqje e cila bëhet me qëllimin e marrjes se pushtetit, nga grupi pranohet dhe kuptohet si pushtet i dhuruar nga lart. Kjo dhuratë e gjakut përbënte pushtetin e magjisë. Marrja e këtij pushteti përmes një veprimi të dhunshëm i jepte dhunuesit prosperitet dhe pushtet. Me fjalë të tjera, pushteti i magjisë buronte nga gjaku dhe ky pushtet merrej përmes shkëlqes se tabusë të gjakut, do të thotë përmes delikteve rituale.

S i - pas kësaj studiueseje, pushteti i magjisë i fituar në këtë mënyrë, identifikohet me manën, burimin e të së shenjtës. Kjo shtonte se studimet e bëra mbi magjinë e themeluar mbi manën, sipas Maussit dhe Hubertit, nuk kishin nxjerrë dallimin e duhur në mes magjisë asociative (simpatisë) dhe magjisë për manën (shkëlqes individuale), apo, nuk e kishin bërë dallimin e përkujdesjes kolektive të tabusë, dhe, në të njëjtën kohë, edhe të shkëlqes së tabusë nga ana e individit.

Ky dallim i bërë nga kjo studiuese, nxori në pah individualen, e cila vendoset në rendin shoqëror dhe sipas saj, akti i shkëlqes së tabusë shfaq një përmbajtje ideologjike të kolektivitetit dhe kjo e themelon manën.

Nga analizat e bëra të kësaj etnografie mbi të shenjtën, arrihet deri te ky përfundim, siç e rrumbullakon vetë autorja në një vepër të saj, kur thotë: “E shenja na shfaqet si një produkt dhe elaborim mental i grupit njerëzor, si

përgjegjëse e nevojës së tyre për të jetuar një mirëqenie, dhe kjo zuri vend para se të ndahet trupi social nga klasa dhe para se të krijohet religjioni në kuptimin që mbërthen kjo fjalë. Popujt të cilët krijuan manën dhe e cila u pasurua më vonë nga kategoria e pastërtisë dhe papastërtisë, nuk kishin për qëllim religjionin, ashtu siç nuk e kanë edhe sot. Ata janë themelues pa dashje të religjionit”. Kështu, kjo autore e përfytyron krijimin e manës dhe të shenjtës tek popujt primitivë, të cilët, sipas saj, nuk kishin për qëllim krijimin e ndonjë religjioni, por ngritjen e mirëqenies në rendin shoqëror.

Flijimi, themeluese e shenjtës: R. Girard

Studimet e bëra nga R. Girard mbi të shenjtën në religjion janë të përqendruara mbi aktin e flijimit apo të dhunës. Sipas vështrimit të tij, argumentin mbi të shenjtën ai e vendos mbi këtë veprim: “Të gjitha dukuritë e religjionit janë të përqendruara në përkujtimin dhe përtëritjen e një njerëzimi të rrënjësor në flijimin e një viktime të dërguar”. Autori në fjalë heton se si objekti i çdo riti dhe kultit është i mbërthyer rreth flijimit të një viktime. Ai mban qëndrimin se ky është kodi i deshifrimit të çdo miti, i cili mund ta deshifrojë dhe ta bëjë të kuptueshëm secilin tekst të religjioneve. Kërkimet e tij rreth këtij argumenti shtrihen si në mitet e religjioneve totemike, por edhe në ato të Greqisë se vjetër, veçmas, në literaturën e tragjedisë greke, heton se si flijimi është boshti i religjionit.

R. Smith që nga viti 1889, ishte përpjekur duke u nisur nga religjionet totemike, për të bërë një interpretim mbi domethënien e flijimit. Në disa fise Arabe, në kohërat e religjionit totemik, ky studiues kishte hetuar se si ishte një doke rituale për të mbytur devën për ta ngrënë me qëllim që të përcillet forca e saj tek ata që e hanin. Smithi paraqiste teorinë se si tek religjionet totemike ekzistonte një gosti flijuese, e cila themelohet mbi besëlidhjen e gjakut dhe mbi flinë rituale. Me këtë teori ishte entuziazmuar Frazeri, sipas të cilit doktrina sakrifikale gjen shpjegimin e saj të fundit në flijimin e hyjnës dhe në bashkimin me këtë viktimitë hyjnore. Gjurmët e religjionit totemik në botën greko romake, i kishte vënë në pah S. Reinach, i cili, në mitet e Orfeut dhe Dionizit hetonte të njëjtin qëllim të kësaj gostie flijuese.

Pranë kritikave dhe divergjencave që janë të pranishme në veprat e R. Girardit, mbi studiuesit e


mëparshëm të religjionit, ky mban qëndrimin se viktimia flijuese ka për qëllim të: “mbajë harmoninë në bashkësi, pranë të gjitha përçarjeve dhe mosmarrëveshjeve që mbizotërojnë në grup, viktimia flijuese e rigjallëron njësimin dhe i jep forcë shoqërisë. Të gjitha të tjerat rrjedhin nga ky burim”. Sipas këtij autori, edhe pse nuk e jep ndonjë definicion mbi të shenjtën, ai të shenjtën e themelon mbi flijimin, të cilin e paraqytirton si një dhunë, mirëpo që ka për qëllim për ta zëvendësuar këtë dhunë me ritin e sakrificës. Ai shton se: “e shenja iu tregon njerëzve çka duhet të bëjnë dhe çka nuk duhet të bëjnë për të shmangur dhunën shkatërruese. Ekzistenca njerëzore mbetet e udhëhequr, e rregulluar dhe e kontrolluar nga e shenja”.

Simboli: pragu i të shenjtës L. L. Bruhl (1857 - 1939)


Nën ndikimin e Durkheimit, L. L. Bruhl, në studimet e tij mbi religjionin sjell risi, të cilat do të bëjnë ndikim të madh në këtë fushë të studimeve. Ai kërkonte që para se të vëzhgohet dukuria e shenjtës në religjionet primitive, të hyhet në mendësinë e reflektimit primitiv. Këtë mendësi ai e karakterizoi si një mendësi paralogjike, e cila ishte e përqendruar në besimin e botës së dukshme dhe botës së padukshme, të botës së natyrshme dhe botës së mbinatyrshme. Njeriu tribal në jetën e tij ka një ndjesi për botën e padukshme dhe të mbinatyrshme, të cilën ai e heton.

Këtu ndërhyjnë funksioni i simbolit, i cili e bën të pranishme botën e padukshme. Simboli tek njeriu tribal, hetoi ky studiues, nuk është vetëm një përfytyrim i qenies mbinatyrore, por përmes simbolit mundësohet edhe pjesëmarrja në jetën e qenies së mbinatyrshme. Për L. Levy Bruhl-in, e shenja vendin e vet e ka në funksionin simbolik, e cila ndërhyr në relacionet e njeriut tribal me qeniet mbinatyrore. E shenja manifestohet në vende, të cilat simbolikisht paraqesin qeniet mbinatyrore. Këto vende të shenja kanë një karakter të shenjtë, mbasi janë vatra të qenieve mbinatyrore.

Teoria e këtij studiuesi dalton nga teoritë e Durkheimit dhe e Maussit, të cilët të shenjtën e lidhnin me manën. L. L. Bruhl të shenjtën e lidh me sjelljen e njeriut arkaik. Sipas këtij studiuesi e shenja nuk është diçka substanciale, por ajo është relacionale, ku njeriu përmes të shenjtës, e cila shprehhet në simbol, vendos lidhjen e tij me qeniet e mbinatyrshme.



Koka e Iullës Sioux (Su)



Figurë e hienës së popullit Nilot

Frytet e ekum.

■ Shkruan:
Don Lush GJERGJI

Para Takimit të Tretë Ekumenik Evropian në Sibiu (Rumani) prej 4 e deri më 9 shtator 2007 do të jetë një rast i mirë për vlerësimin e lëvizjeve ekumenike të deritashme në Evropë dhe në botë, duke shqyrtuar në mënyrë sa më konstruktive dhe dinamike edhe dy Takimet e mëparshme, në Basel (1989) dhe në Graz (1997).

Takimi i Tretë Ekumenik Evropian është përgatitur me shumë nisje, botime, shtegtime, uratë, shkëmbime përvojash, sidomos në këto katër faza apo shkallë në nivelin më të lartë të krishterë në Evropë.

1. Shkalla apo faza e parë përgatitore në Romë, si shtegtim ekumenik evropian prej 24 deri më 27 janar 2007, që përpunet edhe me Javën e Uratës për Bashkim të Krishterëve, dhe me pjesëmarrje të 150 delegatëve të kishave dhe bashkësive të ndryshme të krishtera.

Si qëllim kryesor ky takim kishte shkëmbimin e përvojave dhe të punës ekumenike për t'u takuar "me begatinë e traditave të ndryshme të krishtera dhe për të zbuluar rrënjët e krishtera të Evropës". Kulmi i këtij shtegtimit shpirtëror ekumenik evropian ishte takimi me Papën Benedikti XVI në bazilikën e Shën Palit Jashtë Mureve më 25 janar 2007, në të cilin ai theksoi edhe një herë bindjen e tij dhe të mbarë Kishës Katolike se ekumenizmi tashmë është një domosdoshmëri, një detyrë e të gjithëve dhe për të gjithë, dhe se rruga do të jetë e gjatë dhe e vështirë, pra, na nevojitet guximi e mbi të gjitha hiri dhe ndihma e Zotit dhe bashkëveprimi vëllazëror.

2. Shkalla apo faza e dytë përgatitore ishin takimet e ndryshme ekumenike kombëtare gjatë vitit 2006 apo në fillim të vitit 2007. Secila kishë e krishterë evropiane ka bërë një shqyrtim dhe analizë të brendshme për çështjet ekumenike duke kërkuar rrugë dhe mundësi të reja për ta vazhduar lëvizjen e tashme në zhvillim dhe rritje kudo në botë.

3. Shkalla apo faza e tretë ishte takimi ekumenik në Wittenberg, qyteti i Martin Luterit, më 15-18 shkurt 2007, me dy drejtime dhe orientime kryesore, anën që të tejkalohet historia e ndarjes dhe

e përçarjeve dhe të arrihet ujdja, sepse takimi, afrimi dhe bashkimi i të krishterëve është urdhër i vetë Jezu Krishtit dhe imperativ i kohës dhe botës së sotme.

4. Shkalla apo faza e katër dhe përfundimtare do të jetë në Sibiu (4-9 shtator 2007) si kurorëzim i të gjitha lëvizjeve, lutjeve dhe veprimtarive të ndryshme ekumenike në mbarë Evropën.

“Kontinenti i vjetër ka nevojë për harmoni të brendshme për të ndikuar më mirë në çdo anë të botës... Ne duhet ta promovojmë gjithnjë e më shumë pajtimin mes të gjithë popujve, sepse si të krishterë kemi përgjegjësi lidhur me çështjen e Evropës: të punojmë dhe luftojmë për një botë më të drejtë dhe më solidare duke u nisur prej fesë së përbashkët në të cilën ne besojmë dhe jetojmë... Nuk mjafton më feja apo doktrina për të qenë të bashkuar. Dashurinë e madhe të cilën na e dhuron Krishti, nuk mund mos të ndikojë për ta arritur bashkimin... Bashkimi, para se të jetë një përpjekje, është dhuratë e Zotit... Ne të krishterët duhet ta gjejmë krijimin e një bote, e cila gjithnjë e më shumë është e ndarë dhe egocentrike... Vetëm vëllazërisht dhe bashkërisht kemi të drejtë dhe mund ta shpallim dhe ta dëshmojmë ungjillin e Jezu Krishtit.”

Mons. Vincenzo Paglia

Kjo punë tejet e madhe dhe shumë rëndësishme s'mund të paramendohet pa disa "parakushte" apo veprime të mëhershme të të krishterëve në Evropë dhe në botë.

Çka ka ndikuar pozitivisht që lëvizja ekumenike sot të jetë në qendër të vëmendjes dhe të zemrave të shumë të krishterë?

Sigurisht se ka shumë shkaqe dhe arsye, rrethana dhe personalitete, por unë do t'i përmendi vetëm disa lëvizje dhe ngjarje në gjirin e Kishës Katolike që pa dyshim e kanë ndërruar së pari fytyrën e saj, pastaj atë të të krishterëve në Evropë dhe në botë, si dhe të mbarë njerëzimit.

Ngjarja e parë dhe më e rëndësishme e shekullit XX ishte gjithsesi Konkili i Dytë i Vatikanit, vepër e Shpirtit Shenjt dhe e burrërisë, guximit, fesë dhe e dashurisë së Kishës Katolike në krye me Papën e Mirë Gjonin XXIII (1881-1963) dhe Papa Pali VI (1897-1978) si që vlerësuar nga shumë analistë kulmorë botërorë.

Konkili II i Vatikanit (1962-1965) ishte: *Ekumenik*, si kërkim i bashkimit të plotë mes të krishterëve; *Baritor apo pastoral*, si kërkim i mënyrave më të mira dhe më të përshtatshme për ungjillëzim, katekizim, për shpalljen dhe dëshmimin e Lajmit të Gëzuar të shëlbimit mbarë njerëzimit; *Liturgjik*, me reformën e madhe dhe të begatshme

është ribotuar edhe në vitin 1970, si vegël e çmueshme për të "orientuar, koordinuar dhe zhvilluar". Përpos Konkilit të Dytë të Vatikanit (KDV), Dekretit mbi ekumenizëm UNITATIS REDITEGRATIO", Direktori Ekumenik, në vitin 1983 është promovuar edhe Kodi i të Drejtës Kanonike për Kishën Latine si dhe Kodi i të Drejtës Kanonike për Kishat Lindore (1990) për "rregullimin sa më të saktë dhe të përpiktë të marrëdhënieve ekumenike mes të krishterëve".

Dhe së fundi edhe Katekizmi i Kishës Katolike (1992) është edhe porosia bazë për të gjithë katolikët e botës lidhur me lëvizjen ekumenike, mundësinë, vështirësitë, të arriturat dhe synimet e ndryshme, si dhe edukimi në fe i të gjithë brezave katolikë me porosinë ungjillore për afrimin e bashkimit e plotë me të gjithë të krishterët e botës.

Në vitin 1995 është botuar dhe promovuar edhe PERMBLEDHJA e Katekizmit të Kishës Katolike, që me vite e kishte përpunuar dhe udhëhequr kardinali Jozef RATZINGER, dikur Prefekti i Kongregatës për Doktrinën e Fesë, së bashku me shumë ipeshkvij dhe ekspertë nga mbarë bota, tani Papa Benedikti XVI.

1. Disa veprimtari ekumenike në Evropë gjatë viteve 2006-2007

Si përgatitje për Takimin e Tretë Ekumenik Evropian në Sibiu ishte është shtegtimi i përbashkët në Jerusalemin të gjitha kishave të krishtera (në mbarim të vitit 2006), të cilit i priu kardinali i njohur Italian Carlo Maria Martini (tashmë në pension për shkaqe të moshës), së bashku me kardinalin e tashëm të Milanos Dionigi Tetamanzi, që aty ku Jezusi e kreu veprën e shëlbimit me mundime, vdekje dhe ngjallje, "të Krishterët të firojnë në frymëzim për bashkëpunim dhe bashkëjetesë".

Aty lindi edhe ideja dhe propozimi që një shtegtim i tillë të organizohej edhe në Moskë, gjë që ende nuk është zbatuar, por gjithnjë është në shqyrtim.

Kisha Katolike në Itali ka organizuar Kongresin e Tretë Ekumenik Italian në Terni me temën: "Të Krishterët dhe Evropa" (5-7 qershor 2007).

Pjesëmarrës në këtë Kongres ishin Imzot Vicenzo Paglia, Kryetari i Këshillit për Ekumenizëm dhe Dialog të Konferencës Ipeshvore Italiane; Mons. Aldo Giordano, Sekretari i Këshillit të Konferencave Ipeshvore të Evropës; metropoliti i Kishës Ortodokse në Itali Ferrosi; Pastori Jean-Arnold de Clermont, Presidenti i Konferencës së Kishave të Evropës. Mons. V. Paglia përpunoi hollësisht temën: Roli i të krishterëve për një Evropë dhe botë me solidaritet.

Ai në një analizë të mirëfilltë të gjendjes së të krishterëve në Evropë ndër të tjera tha:

"Kontinenti i vjetër ka nevojë për harmoni të brendshme për të ndikuar më mirë në çdo anë të botës... Ne duhet ta promovojmë gjithnjë e më shumë pajtimin mes të gjithë popujve, sepse si të krishterë kemi përgjegjësi lidhur me çështjen e



enizmit sot

Evropës: të punojmë dhe luftojmë për një botë më të drejtë dhe më solidare duke u nisur prej fesë së përbashkët në të cilën ne besojmë dhe jetojmë... Nuk mjafton më feja apo doktrina për të qenë të bashkuar. Dashurinë e madhe të cilën na e dhuron Krishti, nuk mund mos të ndikojë për ta arritur bashkimin... Bashkimi, para se të jetë një përpjekje, është dhuratë e Zotit... Në të krishterët duhet ta gjejmë krijimin e një botë, e cila gjithnjë e më shumë është e ndarë dhe egocentrike... Vetëm vëllazërisht dhe bashkërisht kemi të drejtë dhe mund ta shpallim dhe ta dëshmojmë ungjillin e Jezu Krishtit!.

Mons. Aldo Giordano ndër të tjera tha: "Krishti e ka dhënë jetën për plagët e ndarjeve dhe të përçarjeve dhe Ai e udhëbëzoi lëvizjen ekumenike. Ne duhet t'ia lejojmë atij që të jetë në mesin tonë duke e njohur dhe pasur më tepër besim në njëri-tjetrin".

Luca Negro Sekretari i KEK-ut (Koferenca e Kishave të Evropës) tha: "Në përmjet Hartës Ekumenike ngadalë

kalojmë prej bazës së dialogut tek faza e pranimit të ndërsjellë nëpër Kishat e Krishtera..."

2. Disa risi dhe theksime të Direktorit Ekumenik

Direktori Ekumenik ka sjellë së pari qartësi teologjike, doktrinare, duke sjellë kështu dukshëm rregullimet apo mjegullimet e mundshme, interpretimet e ndryshme dhe të njëanshme, shpeshherë edhe arbitrare.

Me Direktori Ekumenik shpeshherë dhe dëshmohet angazhimi i Kishës Katolike në lëmin ekumenik:

1. Jepen mjete dhe mundësitë për të vepruar në këtë drejtim (kreu II dhe II);
2. Edukimi për kërkimin e ekumenizmit, bashkimit mes të krishterëve (kreu III);
3. Veprimtaria e llojllojshme ekumenike në gjirin e Kishës Katolike në botë (kreu IV dhe V).

Direktori Ekumenik është plotësuar dhe botuar në vitin 1993 me titull: Direktori për Zbatimin e Parimeve dhe Normave të Ekumenizmit, nënshkruar nga Kardinali Edward Cassidy, President i Këshillit për Ekumenizëm dhe Imzot Pierre Duprey Sekretar, me aprovimin e Papës Gjon Pali II më 25 mars 1993.

3. Vetë Jezu Krishti kërkon dhe fton në bashkim

Ky ishte parimi bazë i Koncilit të Dytë të Vatikanit duke u mbështetur në mesimet teologjike dhe doktrinare.

Kisha e ka një rol të dyfishtë historik: afrimin e njerëzimit kah veprat e shëlbimit dhe bashkimin me Zotin dhe me njëri-tjetrin, sepse ajo është "sakramenti i Shëlbimit", domethënë shenja

dhe mjeti i bashkimit të thellë me Zotin dhe njësimi i mbarë gjinisë njerëzore.

Ky parim gjendet pothuaj në çdo dokument të KDV, veçmas në Lumen Gentium (LG) dhe Unitatis Redintegratio.

Direktori ekumenik vetëm ka thelluar dhe sqaruar disa aspekte të ekumenizmit sipas parimeve bartëse të Koncilit të Dytë të Vatikanit.

Kisha, si vazhdim historik i veprës së shëlbimit, të cilën e kreu Jezu Krishti me mundimin, vdekjen dhe ngjalljen, na fton të gjithëve në bashkimin dhe në njësim me fuqinë e Shpirtit Shenjt dhe kështu e kryen misionin e saj ungjilëzues dhe shëlbimprurës.

Bashkimi mes Kishave vendore me Kishën amë të Romës dhe me njëra-tjetrën është dhuratë e Zotit, sepse në këtë mënyrë dëshmohet prania dhe udhëheqja e tij në ditët tona.

Katolikët janë thellë të bindur se e vetmja Kishë e Krishtit në plotësi është Kisha Katolike, e udhëhequr në mënyrë të pashme apo të dukshme prej pasardhësit të Shën Pjetrit, kryepostullit dhe ipeshkvijve në bashkim me atë, sepse: Ka tërësinë e të vërtetave të zbuluara; Sakramentet dhe shërbimet apo shkallët e ministrave, edhe pse fatkeqësisht nuk ka jetuar dhe vepruar me besnikëri dhe me dashuri; Ndajet dhe përçarjet mes të krishterëve janë fryti i mëkatit dhe jobsnikërisë, së pari ndaj Zotit, Kishës, pastaj ndaj njeriut dhe bashkësisë për çështje doktrinare dhe morale që domethënë të mesimit dhe të besimit të fesë, si dhe të organizimit dhe praktikës së përditshme.

Direktori Ekumenik thekson fuqimisht dhe bindshëm se bashkimin e do dhe e kërkon vetë Jezu Krishti. Ky bashkim zbatohet "nëpërmjet predikimit apo shpalljes besnike të Ungjillit, ndarjes së sakramenteve dhe udhëheqjes së Kishës me dashuri nga ana e apostujve dhe pasardhësve të tyre, domethënë të ipeshkvijve në krye me pasardhësit e Pjetrit".

Pamje nga një seancë e Koncilit II të Vatikanit



Ekumenizmi i mirëfilltë ka për qëllim që bashkimi të jetë në shërbim të "dëshmitit të fesë së përbashkët, në kremtime të përbashkëta të kultit hyjnor dhe në harmoninë vëllazërore të familjes së Hyjit".

Këto tri pika apo shtylla të ekumenizmit janë shumë aktuale edhe sot në Evropë dhe në botë, sepse pa dëshmi të krishterë s'ka shpallje të Fjalës së Zotit, Ungjillëzim dhe katekizim. Bota e sotme ka nevojë për predikatorë, por edhe më tepër për dëshmitarë, si thoshte Papa Pali VI.

Kremtimet e përbashkëta liturgjike, sidomos Eukaristia, Sofra e Pranisë dhe e Dashurisë së Zotit ndër ne dhe për ne, do të ishte burim fuqie për ta falur njëri-tjetrin si persona dhe si kisha, si bashkësi të krishtera dhe për të kërkuar falje prej njëri-tjetrit, qëndrim ky që kërkon shumë guxim dhe përvujtëri, mbi të gjitha fe të madhe dhe dashuri flijuese dhe vepruese.

Patriku ekumenik gjithë Ortodoks, Shqiptari dhe Profeti i madh i bashkimit mes të krishterëve, Atenagora I (1886-1972) shpeshherë thoshte kështu: "Ne mendojmë kah çasti i madh dhe i Shenjtë, kur ipeshkvijtë e Perëndimit dhe të Lindjes do të bashkëmbeshojnë në të njëjtin Lter, duke ngritur kalkun e Zotërisë nga Eukaristia e përbashkët. Kjo kohë ndoshta do të jetë më vonë. Por ora, koha e dashurisë, ja, është e pranishme, është këtu... Papa është lideri, kreu i ynë dhe ne jemi rreth

tij. A e dini si e shoh unë Shenjtërinë e Tij? Në agoni, sepse ai i di të gjitha gjërat e këqija të botës... Ne shpresojmë se do të takohemi në të njëjtin Kelk të Gjaktit të të njëjtit Zotëri, të së njëjtës Zonjë Mari, të së njëjtës Kishë, të së njëjtës jetë dhe në amshim..."

Harmonia vëllazërore e familjes së Hyjit, e Kishës, do të ishte vërtet një dëshmi e madhe dhe një fuqi mes të krishterëve të Evropës dhe në botë.

Për t'ia arritur këtyre qëllimeve kaq të larta, këtyre synime kaq të thella, këtyre qëndrimeve kaq të krishtera, na nevojitet kthimi i plotë dhe i vazhdueshëm kah burimi, Jezu Krishti, sepse vetëm më Të dhe në Të, ne edhe pse të dobët dhe mëkatarë, dëshmojmë Praninë dhe Dashurinë e Zotit në botën e sotme. Kjo Prani dhe Dashuri kremtohet në jetën sakramentale, veçmas në Eukaristi dhe vetëm nga kjo Sofër rritet feja, ngjallet shpresa dhe ndizet dashuria, formohet familja e re e Popullit të Zotit, Kisha e tij në botën e sotme.

Kjo do të zbrëthente në harmonizimin e Popullit të ri të Zotit, Kishës, për takim, afrim dhe bashkim në dallim mes të krishterëve në Evropë dhe në botë, kontribut ky shumë i madh dhe tejet i rëndësishëm për paqe dhe pajtim në kohën tonë.

Vetëm kështu të krishterët do të ishin sot dhe gjithnjë Drita dhe kripa e botës, vetvetja, si nxënës dhe dëshmitarët e Jezu Krishtit dhe të ungjillit të tij.

“Ne mendojmë kah çasti i madh dhe i Shenjtë, kur ipeshkvijtë e Perëndimit dhe të Lindjes do të bashkëmbeshojnë në të njëjtin Lter, duke ngritur kalkun e Zotërisë nga Eukaristia e përbashkët. Kjo kohë ndoshta do të jetë më vonë. Por ora, koha e dashurisë, ja, është e pranishme, është këtu... Papa është lideri, kreu i ynë dhe ne jemi rreth tij. A e dini si e shoh unë Shenjtërinë e Tij? Në agoni, sepse ai i di të gjitha gjërat e këqija të botës... Ne shpresojmë se do të takohemi në të njëjtin Kelk të Gjaktit të të njëjtit Zotëri, të së njëjtës Zonjë Mari, të së njëjtës Kishë, të së njëjtës jetë dhe në amshim...”

ATENAGORA

Ordinariati ipeshkvor në Tivarë, viti 1937



Arq

*Besimtarët e Arq
feja tek ata baze
kimit adekuat a
paraqet dukuria
pala katolike në
negative: indife
fëmijëve dhe të*



Katedralja e Zojës së Papërlyer e Arqipeshvisë së Tivarit



Kisha e shën Nikollit, Tivar

■ Shkruan:
Don Albert JAKAJ

1. HISTORIKU I DIOQEZËS

Pozita gjeopolitike e Kryepeshkvisë së Tivarit në kufirin në mes Lindjes dhe Perëndimit, do të luante rol mjaft të rëndësishëm në Kishën universale, pas ndarjes së vitit 1054, po të mos merrnin ngjarjet historike udhë tjetër. Tivari, ipeshkvia e dikurshme, ishte nën metropolin e Duklës, por me shkatërrimin e Duklës, ajo bie nën Salonië (metropolinë e Splitit). Tivari atëherë e trashëgon kryepeshkvinë duklane, gjë kjo që binte në kundërshtim me Dubrovnikun, duke konsideruar se atij i takonte trashëgimi. Sunduesit e Duklës (Zetës) përqipeshin të fitonin për Tivarin titullin Arqipeshkvor e Metropolit. Mihailo Vojislavljeviq do të arrijë të fitojë nga Papa Gregori VII kurorën mbretërore, po jo edhe nderin kryepeshkvor për Tivar, sipas gjasave, për shkak të Dubrovnikut (Kryepeshkvisë e Republikës). Birrit të tij, Bodinit, kjo i shkon për dore nga protopapa Klementi III në vitin 1089. Me bullën e dhënë kryepeshkvit Pjetrit, ai vërteton të drejtat metropolitane. Disa historianë janë të mendimit se Arqipeshkvia ka ekzistuar edhe më parë (që nga viti

1062 ose 1067). Sidoqoftë gjatë sunduesve duklan Arqipeshkvia e Tivarit ka përjetuar famë të madhe e të drejta, të cilat i takonin si Arqipeshkvi dhe Metropoli. Para kësaj në vitin 1199 mbahet Sinodi I i Tivarit me propozimin e mbretit Vukan Nemanjiq (i biri i Stevan Nemanjes) dhe në praninë e delegatëve papnorë. Zgjidhen problemet kishtare në Krahinën e metropolisë së Tivarit. Rëndësia që Selia Shenjte i dha Arqipeshkvisë së Tivarit, shihet në faktin se për Tivar e vendosi njërin prej diplomatëve të saj të mëdhenj, ambasadorin në Mongoli, Gjonin nga Piano Karpini, i cili do t'iu jepte fund konflikteve me Arqipeshkvinë e Dubrovnikut në favor të Arqipeshkvisë së Tivarit, por ishte bërë tepër vonë.

Sulmi i parë në rolin dhe pushtetin e saj bie me themelimin e Kishës ortodokse Serbe në vitin 1219, në kohën kur ortodoksizmi depërton gjithnjë e më tepër tek elementit sllav në këto hapësira, veçanërisht tek Nemanjiqët, prej të cilëve disa si p.sh. Perandori Dushan Silni, kanë qëndrime armiqësore ndaj katolikëve (herezia latine). Kisha e Tivarit është qysh në atë kohë në mbrojtje ndaj këtyre sulmeve. Gjatë kohës së Balshajve (të cilët i kthehen katolicizmit) dhe gjatë kohës së sundimit venedikas prej 150 vitesh në këto troje, roli i saj prapë gjallërohet, derisa më në fund me rënien e Tivarit nën Perandorinë Otomane në vitin 1571, i është dhënë një goditje gati vdekjeprurëse, kështu që gjatë 300 vjetësh të sundimit turk, aktiviteti i saj do të reduktohet të mbijetojë e ta ruajë atë që mund të ruhet, duke u orvatur në dy fronte: kundër ortodoksizmit të favorizuar dhe Islamit sundues. Me islamizimin e popullsisë, prej dhunës apo prej interesit, numri i besimtarëve të saj u zvogëlu, duke i vënë në sprovë e kërcënime të ndryshme, që të mohojnë fenë e tyre. Është një mrekulli e vërtetë që të krishterët nuk janë zhdukur, por kjo ndodhi me shumë vetëmohime e përkushtime, pjesërisht edhe me shpërngulje.

Kur Mali i Zi në betejën e Veljes (në vitet 1876-78) përhapit kufijtë dhe përfundimisht del në det, Arqipeshkvia e Tivarit (në atë kohë e reduktuar në 4 apo 5 famulli me besimtarë sllavë dhe 2 famulli me besimtarë shqiptarë), u gjet në një situatë të re. Jo më nën sundimin turk, por tani nën atë ortodoks dhe kuptohet në pakicën edhe pse i kishte fituar disa famulli të Arqipeshkvisë së Shkodrës. Me lidhjen e Konkordatit në mes të Principatës së Malit të Zi dhe Selisë Shenjte, gjendja e katolikëve në situatën e re rregullohet në pikëpamje juridike dhe deri diku edhe përmirësohet. Por kjo situatë shkakton edhe probleme, për të cilat barinjtë e Tivarit kërkojnë zgjidhje të përshtatshme që të kenë mundësi për ta ruatur këtë grigjë të vogël 'reliquiae reliquiarum'. Mungesa e klerit të vendit ndikon që të mos të arrihet as në rrethanat e reja ajo çka do të dëshirohej. Fakti se edhe në Principatën (Mbretërinë) e Malit të Zi dhe në Mbretërinë Slloveno-Kroato-Serbe, përkatësisht në Jugosllavinë e parë, Arqipeshkvia e Tivarit edhe pse ishte drejtpërdrejtë nën juridiksionin e Selisë Shenjte, trajtohej nga pikëpamja

fetare dhe etnike, pra konsiderohej si pakicë gjeogjesisht si trup i huaj, sepse ortodoksizmi është konsideruar si fe zyrtare e shtetit; ajo edhe pas të gjitha përpjekjeve të Arqipeshkvit Dobreqiq nuk ka mundur të bëjë atë se çka dëshironte. Aktiviteti i Kishës është reflektuar në pastoralin tradicional, edhe pse ka themeluar jetimore, foshnjore e seminare – gjithsej 3, që ishin institucione të reja për këto vende. Kisha është dashur të luftojë që të ekzistonte ose më mirë të themi që të shpëronte atë çka mund të ruhej.

Me ardhjen e regjimit ateist, pra të komunizmit dhe me ndarjen e Kishës nga Shteti, Arqipeshkvia e Tivarit (ashtu edhe religjionet tjera) ndodhet në një situatë të vështirë. Fetë konsideroheshin si 'opium i popullit', ndërsa si katolikë, konsideroheshin si bashkëpunëtorë të okupatorit ose armiq të popullit. Kisha e Tivarit në këtë sistem ishte e shtyrë, siç thuhet, të punojë në "Sakristi", sepse asnjë veprimtari e jashtme nuk ka qenë e lejuar. Prapë në Kishë kryhej çdo gjë që ishte e nevojshme. Gjendja e besimtarëve ishte e vështirë – që të mbaheshin dhe deklaroheshin si besimtarë. Ka pasur edhe tradhti, largime nga Kisha. Kur u hapën kufijtë rreth viteve '60, ndodhi një vështirësi e re: shpërnguljet, njerëzit braktisnin vatrat e tyre, kështu që gjendja e shpirtit të Arqipeshkvisë u zvogëlu përgjysm.

Me një fjalë, me zhvillimin e ngjarjeve historike dhe me largimin e disa barinjve nga dioqezja e tyre, i kja e klerit në vendet më komode para depërtimit të Islamit, mungesa e klerit vendas, ka kontribuar që Arqipeshkvia e Tivarit, qoftë si Metropoli, qoftë si Dioqezë e pavarur, nuk mundi të luajë një rol të cilin e kishte si urë në mes Lindjes e Perëndimit. Megjithatë është i vetmi institucion fetar, i cili në këto hapësira e ka periudhën më të gjatë të ekzistimit.

2. ORGANIZIMI ADMINISTRATIV I DIOQEZËS

Arqipeshkvia e Tivarit përbëhet prej 3 dekanateve:

1. Dekanati i TIVARIT (ndodhet në qendër të dioqezës); përbëhet nga këto famulli (Famullia e Tivarit me 1.428 besimtarë; Zupce – 120; Cetine – 30; Ljarë – 41 dhe Shestani – 14).

2. Dekanati i PODGORICËS, dekanati më i madh për nga numri i besimtarëve dhe ndodhet në veri të dioqezës) përbëhet nga famullia e Podgoricës me 1.709 besimtarë; ajo e Nikshiqit me 20; Gucia – 83; Gruda – 230; Hoti – 425; Trijeshi – 255; Koja – 413 dhe Tuzi – 4.450 besimtarë. Këto pesë të fundit përbëjnë Misionin Francëskan në Malësi dhe bën pjesë në Provincën francezkanë të Shën Jeronimit të Zarës (në Dalmaci), ndërsa famullia e Podgoricës u është besuar Etërve Salezian të Provincës saleziane sllovene të Shën Çirilil e Metodit, Lubianë (Slloveni).

3. Dekanati i ULQINIT (ndodhet në jug të dioqezës) përbëhet nga famullia e Ulqinit me 961 besimtarë; Shtoji – 492; Shën Gjergji – 241; Kollomza – 219; Bratica – 472

Arqipeshkvia e Tivarit

Arqipeshkvisë së Tivarit janë 90 % shqiptar. Si besimtarë janë të mirë, por ohet më shumë në traditë se sa në bindje personale, kjo si pasojë e mosedulthe rrethanave të vështira që kanë kaluar. Në jetën familjare problematike dhe martesave të përziera (sidomos në famullitë e Tivarit e Podgoricës), ku shumicën e rasteve është e dëmtuar. Pasojat e martesave të përziera janë rentizmi fetar, iredizmi ('secila fe është e mirë'), mungesa e edukimit të rriturve në ato familje.

dhe Kllezna – 91.

Meshtarë dioqezanë aktualisht që veprojnë në dioqezë janë 8 (Don Milorad Defar, Don Tomë Koqoviq, Don Fran Markiq, Don Viktor Dedaj, Don Simo Luljiq, Don Nikson Shabani, Don Albert Jakaj e Don Robert Jakaj), të cilët mbulojnë të gjitha famullitë e Dekanatit të Ulqinit dhe Tivarit. Moshë e meshtarëve është mesatare, me prejardhje janë nga territori i dioqezës, ndërsa në vitin 2006 dioqeza ka fituar 3 meshtarë dioqezanë nga Ipeshkvia e Kosovës si 'Fidei donum' (Don Nikson Shabani, Don Albert Jakaj e Don Robert Jakaj).

Rregulltarët e pranishëm në dioqezë janë Françeskane, të cilët veprojnë në veri të dioqezës, pra në Dekanatit e Podgoricës dhe kanë në mbikëqyrje pesë famulli (Tuzin, Grudën, Hotin, Trieshin e Kojën), po ashtu drejtojnë një Qendër Pastorale, një Qendër për fëmijë... Kuvendi Françeskan përbëhet nga pesë bashkëvëllezër (Fra Pashko Gojçaj, Fra Dedë Markolaj, Fra Fran Dushaj, Fra Prelë Gjurašaj e Fra Mirash Marinaj), të gjithë me prejardhje nga vendi, me përjashtim të njërit të ardhur nga Shqipëria. Me numër janë 5 frerë, për sa i përket moshës një është krejt i ri, tre të moshës së mesme dhe një i moshuar.

Misioni françeskan me qendër në Tuz u themelua me një Kontratë ndërmjet Ordinariatit të Tivarit dhe Provincës françeskane të Shën Jeronimit nga Zara (Kroaci), të aprovuar nga Kuria e përgjithshme e OFM dhe të Kongregatës Papnore Propaganda Fide (Ungjilëzim e Popujve) me 21 dhjetor të vitit 1965, me të cilën u jepen 5 famulli "ad nutum Sanctae Sedis" Françeskane (pra bëhet fjalë për famullinë e Grudës, Tuzit, Hotit, Trieshit dhe Kojës).

Bashkësi tjetër rregulltare është ajo e Etërve Salezian në Podgoricë. Kjo bashkësi përbëhet nga 4 meshtarë të moshës së mesme. Tre prej tyre janë me kombësi slovene (Don Janez Mirtek, Don Viktor Ganc e Don An-

drej Baligaë) dhe një me kombësi shqiptare (Don Nosh Gjollaj).

Salezianët veprojnë në kryeqytetin e vendit, po ashtu kanë nën mbikëqyrje famullitë e Nikshiqit dhe të Cetinjes. Po ashtu në Podgoricë udhëheqin Qendrën Rinore dhe disa kurse profesionale (gjuhë të huaja, kuzhinë...).

Në nëntor të vitit 1968 u bë një Kontratë ndërmjet Ordinariatit të Tivarit (në krye me Ordinarin e atëherëshëm Imzot Aleksandër Tokiq) dhe Provincës saleziane slovene, që famullia e Podgoricës iu besua salezianëve, po ashtu "ad nutum Sanctae Sedis".

Në Arqipeshkvinë e Tivarit veprojnë po ashtu edhe Motrat françeskane të Zojës së Papërlyer me seli në Cetinë, ku ndodhet shtëpia provinciale dhe deri vonë ka qenë aty edhe Noviciati e tani ka mbetur vetëm Provincialati.

Këto motra me veprimtarinë e tyre pastorale e katekistike, mbulojnë gati tërë territorin e dioqezës d.m.th gati të gjitha famullitë. Ato merren jo vetëm me katekizëm, por edhe me këndim kishtar, me përgatitje të programeve me fëmijë e të rinj për festa dhe manifestime të ndryshme gjatë vitit kishtar. Përveç pastoralit nëpër famullia, motrat merren edhe me veprimtari shëndetësore, qoftë me punë në Spitalë apo me patronazhe.

Motrat françeskane të Zojës së Papërlyer me prejardhje janë nga vendet e ndryshme: Sllovenia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, por shumica prej tyre janë me prejardhje nga Kosova.

Thirrjet meshtarake e rregulltare janë të pakta. Kemi vetëm tre seminarista (Gabriel Grabanica, Palush Gjinaç dhe Simon Filipaj) në Seminarin e Lartë në Shkodër.

3. PASTORALI

Katekizmi bëhet nëpër të gjitha famullitë qoftë nga ana e meshtarëve, shumë herë edhe me angazhimin e motrave Françeskane të Zojës së Papërlyer me shtëpi provinciale në Cetinë.


Katekeza është sistematike dhe e rëndomtë javore, për të gjitha klasat e Tetëvjeçares.

Jeta sakramentale është më e pasur tek fëmijët dhe të rinjtë sesa tek të rriturit, gjë që shpjegohet me faktin se kohëve të fundit me anë të katekizmit të rëndomtë është ngritur dukshëm vetëdija fetare tek brezat e ri.

Për sa i përket lëvizjeve të ndryshme shpirtërore, ato janë të pakta dhe të karakterit klasik e tradicional.

Mbahen misionet nëpër famulli dhe kjo ka ndodhur me rastin e vitit të krenimitit 2000 vjetorit të krishterimit, ndërsa sivjet në kontekstin e vitit Jubilar ka pasur forma tjera përsëritëse siç janë: simpoziume, shtegtime nëpër festa të patronëve të famullive, takime me fëmijë, takime me të rinj në nivelin dioqezan.

Shtypi në Arqipeshkvinë e Tivarit është paksa i varfër, por megjithatë botohen dy revista mujore, njëra në gjuhën shqipe "Zani i Shna Ndout" (Tuz) dhe tje-



Tivari i vjetër në shekullin XV

Tivari i vjetër sot



Ordinariumi i Arqipeshkvisë së Tivarit

tra në gjuhën sllave "Sv. Nikola" – Shën Nikolla – Tivar. Po ashtu çdo tre muaj del edhe një periodik me titull: "Obavjesti – Lajmërimet", është organ zyrtar i Ordinariatit kryepeshkvor.

Për sa i përket literaturës liturgjike-biblike si edhe të asaj pastorale-katekistike, shërbehemi me libra të ardhura nga Shqipëria apo nga Kosova.

Megjithatë edhe Ordinariatit Arqipeshkvor kohëve të fundit mundohet të botojë herë pas here ndonjë libër fetar dhe edukativ.

4. MALI I ZI DHE GJENDJA FETARE SIPAS BESIMEVE

Mali i Zi është shtet i pavarur që nga viti 2006. Sipas rezultateve të regjistrimit të vitit 2003, Mali i Zi ka 672.655 banorë. Shqiptarë janë 47.682 ose 7,09% ; serbë 30,01% ; boshnjakë 9,41% ; myslimanë 4,27% etj. Sipas besimeve: ortodoksë 69,61% ; myslimanë 20,98% ; katolikë 4,19% (në të dy dioqezat, Tivarit dhe Kotorit).



“Emigracioni është fenomen shumë i pranishëm në Arqipeshkvinë e Tivarit. Pothuajse gjysma e besimtarëve gjinden jashtë vendlindjes, si në SHBA dhe në Evropë. Shpërngulja ishte intensive pas Luftës II Botërore, sidomos gjatë viteve 1960-70. Shpërngulja është në rënie e sipër, por ende nuk ka marrë fund si dukuri. Motivet e shpërnguljes ishin dhe janë ende sot arsyt ekonomike dhe politike. Evidente në këtë problematikë të shpërnguljes janë mungesa e arsimimit në gjuhën amtare, papunësia si dhe pasiguria për të ardhmen, e në disa periudha gjendja e pa perspektivë, e kjo dukshëm ka ndihmuar në largimin e njerëzve nga vendlindja, në mënyrë të veçantë kjo dukuri është shfaqur tek të rinjtë.”



Një biografi juaja (vendlindja, datelindja, prindërit, shkollimi, vendet dhe detyrat ku keni vepruar deri në emërimin Tuaj arqipeshkëv i Tivarit).

Imzot Zef Gashi: U linda në Peshter, afër Prishtinës më 4 dhjetor 1938. Shkollën fillore tetëvjeçare e kreu në vendlindje. Në vjeshtën e vitit 1955 hyra në rregullin salezian dhe kreu gjimnazin klasik në Rijekë (Kroaci) 1959. Hyra në noviciat në vitin 1960 dhe më 24. 08. 1961 bëra kushtet e para në Kongregatën Saleziane. Më 29. 08. 1967 bëra kushtet e përfundimit dhe më 29. 06. 1969 u shugurova meshtar në Zagreb (Kroaci). Meshën e parë ia kushtova Zotit më 13 korrik të po këtij viti, në vendlindje. Për 22 vjet me radhë kam shërbyer si famullitar në Prishtinë dhe Peshter, detyrë të cilën e ushtrova deri në vitin 1992. Nga 12 shtatori 1992 e deri më 10 korrik të këtij viti, kur nga Selia Shenjte u emërova Krqepeshkëv i Tivarit, shërbeva si drejtor i Institutit Katekistik Kombëtar në Shkodër, brenda të cilit edhe themelova shkollën katekistike katër-vjeçare. Gjatë kësaj kohe shërbeva edhe si famullitar i famullisë së Berdicës, Trushit dhe Grudës së re.

Thirrja juaj meshtarake dhe rregulltare, si lindi? Kush iu nixti të filloni këtë jetë?

Imzot Zef Gashi: Thirrja ime meshtarake ka të bëjë shumë me salezianët slovenë që atëherë vepronin në famullinë e Janjevës dhe filialin e saj në vendlindjen time, Peshterin. Veprimtaria e tyre baritore, ndonëse me shumë sakrificë më nxishte të mendoj për meshtarinë time të ardhme. Trimëria e famullitarit don Vinko Sraka dhe zelli baritor i kapelanit don Franc Kuhar më motivonin për ditë e më tepër. Gjithë kësaj iu bashkangjit më vonë edhe ardhja e dy teologëve të atëhershëm don Tunë Glasnović dhe don Luka Cirimotić. Kontakti me ta në orët e katekizmit, në biseda të veçanta personale rreth çështjes së thirrjes meshtarake, më entuziazmonin gjithnjë e më tepër. Kurorëzimi i gjithë kësaj atmosfere shpirtërore ishte Kisha, edhe pse kohë e shkurtër e përgatitjes për krezmim që ndodhë në vitin 1952 në kishën e Shën Kollit në Janjevë. Atë ditë i ndriçuar nga Shpirti Shenjt dhe i përfurcuar nga shtatë Dhuratat

e Tij përfundimisht u vulos vullneti im për t'u nisur në seminar. Ashtu edhe ndodhi më 24 gusht, kur u nisa për Rijekë (Kroaci).

Arqipeshkvia e Tivarit daton nga viti 1089, si ipeshkvi nga viti 451

Tivari Arqipeshkvi, një histori të shkurtër të kësaj Arqipeshkvie të lavdishme gjatë shekujve, dikur shqiptare e me kohën pëson një rënie, dhe ngritja e saj...

Imzot Zef Gashi: Arqipeshkvia e Tivarit sipas të dhënave historike figuron që nga viti 1089, ndërsa si ipeshkvi është shumë më e vjetër dhe daton nga viti 451. Në Selinë e saj nëpër shekuj gjejmë si kryepeshkëv misionar italianë, gjermanë, kroatë dhe më së shumti kuptohet prelatë shqiptarë vendas, nga Shqipëria e veçanërisht nga qyteti i vjetër Shkodra. I pari kryepeshkëv nga Kosova ishte Imzot Pjetër Mazrrek, që e udhëhoqi këtë arqipeshkvi për një kohë të shkurtër në vitet 1628-1634.

Arqipeshkvia e Tivarit gjatë shekujve ka pasur një shtrirje jashtëzakonisht të madhe. Në lindje ka mbërritur deri në Bullgari, në veri te Srijem, ndërsa në Perëndim deri në Bosnje. Në kulminacionin e vet ka pasur 12 sufragane, si na informon në mes tjerash edhe P. Daniëlo Farlati në *Iliricum Sacrum*, Vëllimi VII.

Aktualisht, Arqipeshkvia ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 13 000 m² dhe një popullsi rreth 550 mijë banorë, me rreth 13 000 besimtarë dhe 17 meshtarë e ndarë në dekanate: dekanati i Podgoricës (veri), dekanati i Tivarit (i mesëm) dhe dekanati i Ulqinit (jugu). Arqipeshkvia e Tivarit sivjet kremton 150-vjetorin e ndërtimit të Katedrales kushtuar Zojës së Papërlyer, të cilën e ndërtoi arqipeshkvi i Tivarit, me prejardhje gjerman, Karlo Pooten, në vitin 1857, në pjesën e vjetër të qytetit që quhet Grevta.

Rënia e Arqipeshkvisë daton me themelimin e Kishës ortodokse serbe më 1219 (24), sepse pas kësaj ngjarjeje fillon procesi i kalimit të besimtarëve katolikë në ortodoksi. Ky proces ka ndodhur shpesh herë me dhunë e persekutim, sidomos në kohën e car Dušan-it.

Periudha e dytë e zvogëlimit

të Arqipeshkvisë së Tivarit ishte kalimi i katolikëve të kësaj dioqeze në fenë islame, proces ky që zgjati disa shekuj.

Faktori i tretë i zbritjes rapide të numrit të besimtarëve të Arqipeshkvisë ishte sistemi shoqëror ateist që dominonte në këto treva në gjysmën e dytë të shekullit 20. Ky sistem i kombinuar me nacionalizmin e popujve më të mëdhenj në ish Jugosllavin shkaktoi largimin e shqiptarëve (sidomos) të atyre katolikë nga këto treva. Kjo tendencë e largimit nga vendlindja vazhdon, mjerisht, edhe tash, megjithëse me një intensitet më të vogël dhe me motive të ndryshme në krahasim me ato fillestare.

Numri i besimtarëve në arqipeshkvinë Tuaj, migrimet në Amerikë e gjetu, lidhjet shpirtërore e fizike që keni me diasporën e Arqipeshkvisë Suaj?

Imzot Zef Gashi: Migrimet nga hapësirat e Arqipeshkvisë së Tivarit janë të hershme, për atë marrin përmasa të mëdha sidomos pas Luftës së Dytë botërore dhe në veçanti pas viteve të '60. Migrimet apo shpërnguljet janë të karaktereve të ndryshme sa politike aq edhe ekonomike. Presioni i vazhdueshëm në baza kombëtare dhe fetare, vështirësitë rreth shkollimit si dhe papunësia e madhe, i detyruan njerëzit tonë ta braktisin vendlindjen e vet dhe ta marrin botën në sy për të mbijetuar. Lidhjet e njerëzve tanë nga diaspora me vendlindje janë duke u përmirësuar kohëve të fundit, për shkak të lehtësimit të marrjes së dokumenteve të udhëtimit. Për sa i përket personit tim dhe kontakteve me besimtarët në diasporë, mund të them se i vizitoj mjaft shpesh me rastin e krezimeve apo ndonjë feste tjetër. Po ashtu kur ata vijnë në pushime në vendlindje. Kohëve të fundit fretnit e Tuzit, organizojnë edhe takime të veçanta për mërgimtarë me programe të pasura dhe të bukura. Në këto takime marr pjesë edhe unë si bari dhe në fund të programeve iu drejtohem me disa fjalë dhe me bekim ipeshkvor.

Gjendja e shqiptarëve në Mal të Zi nuk është e kënaqshme

Cila është gjendja politike, sociale e shqiptarëve në Mal

të Zi, para dhe pas pavarësisë, me theks të veçantë të katolikëve atje?

Imzot Zef Gashi: Gjendja politike dhe sociale e shqiptarëve në Malin e Zi, para dhe pas pavarësisë nuk ka ndryshuar fort, sepse as në jetën politike të vendit nuk ka ndryshime të mëdha në përgjithësi, sepse ende është në fuqi Kushtetuta e mëparshme.

Ndryshimet mund të ndodhin me Kushtetutën e re, e cila është në përgatitje e sipër. Kur të aprovohet Kushtetuta e re, nga e cila nxirren ligjet, atëherë do të shihet se sa do të ketë ndryshime në jetën e qytetarëve në përgjithësi, sikurse edhe në jetën e shqiptarëve, si pjesë e kësaj shoqërie.

Nëse teksti i Kushtetutës do të akordohet me standardet e BE-së, atëherë nuk ka vend për skepticizëm, as për pakicat kombëtare në Mal të Zi.

Siç qëndron situata tash, mund të thuhet se në Mal të Zi në përgjithësi, e për shqiptarë në veçanti probleme të mëdha dhe brengosëse paraqesin papunësia, standardi i ulët i jetës, mosinteresi për shkollim etj. Gjithë

kësaj mund t'i shtohet edhe një lloj defetizmi, mungesë perspektive për një të ardhme më të mirë në të gjithë sektorët e jetës, si pasojë e një ë kaluare të çrregulluar, sidomos në dy dekadat e fundit.

Drita ishte thesar kulturor dhe fetar i pakrahasueshëm

Dëshëm të dimë edhe për punën tuaj si punëtor i palodhshëm në fushën e kulturës, për botimet e në veçanti për veprimtarinë në revistën DRITA kur ishit në Prishtinë.

Imzot Zef Gashi: Puna ime në shërbim të kulturës ose veprimtarisë botuese, mund të shihet në tri periudha ose në tre vende: Prishtinë, Shkodër, Tivar.

Për sa i përket periudhës së parë, mund të them se ajo karakterizohet me bashkëpunimin tim të ngushtë me imzot Simon Filipaj, famullitarin e atëhershëm të Shën Gjergjit. Ai m'i jepte tekstet e përkthyer shqip me përmbajtje biblike (Ungjilli sipas Mateut, Bibla e Ilustruar, Besëlidhja e re, Bibla integrale), mandej tekstet liturgjike (leksionarët ABC, Shenjtërit, Ritu-



Imzot Zef Gashi dhe Papa Benedikti XVI

drejt alizoje aspiratat e saj

Arqipeshkvia e Tivarit gjatë shekujve ka pasur një shtrirje jashtëzakonisht të madhe. Në lindje ka mbërritur deri në Bullgari, në veri të Srijem, ndërsa në Perëndim deri në Bosnje. Në kulminacionin e vet ka pasur 12 sufraganë, si na informon në mes tjerash edhe P. Danielo Farlati në Iliricum Sacrum.

alet, Sakramentet, Mesharin për popull dhe Mesharin e madh) dhe më në fund disa tekste katekistike (Katekizmi i vogël, Drita hyjnore etj.). Pra, shumë prej këtyre teksteve kanë kaluar nëpër duar të mia, qoftë për shkak të daktilografimit, qoftë për ta bërë lekturën gjuhësore tek gjuhëtarët nëpër Prishtinë.

Pas kësaj, tekstet dorëzoheshin në Ferizaj tek imzot Nikë Prela dhe don Lush Gjergji, të cilët i kishin mjetet për botim.

Në këtë periudhë punën më të vështirë e kam pasur me botimin e leksionarëve ABC (1975-76), sepse më duhej të bëja vetë tërë punën daktilografike, shumëzim në ciklostil (250 ekzemplarë), financimin, shpërndarjen nëpër famull gjatë takimeve mujore me meshtarë që mbaheshin në atë kohë në Kosovë. Kur është fjala për këtë periudhë e parë të veprimtarisë sime kulturore-botuese, sidomos për sa i përket revistës DRITA, dëshiroj të përkujtoj se kam qenë bashkëpunëtor i të gjithë 4 kryeredaktorëve (imzot Nikollë Mini, imzot Damjani Kurti, P. Hil Kabashi, dr. Lush Gjergji). Ndiej

kënaqësi të madhe që me një angazhim të fortë më shkoi për dore revistën DRITA ta bashkoj nga të gjitha famullitë dhe ta lidh në 6 vëllime. Tash, kur kohë pas kohe i shfletoj këto vëllime, me duket se në revistën DRITA përplot dy dekada e kemi pasur një thesar kulturor dhe fetar të pakrahasueshëm. Për këtë arsye gëzohem shumë që ka rifilluar botimi i saj. Ju lumtë!

Periudhën e dytë e përfshin qëndrimi dhe veprimi im 6-vjeçar në Shkodër. Atje së bashku me don Dominik Qerimin, pranë Qendrës Don Bosko patëm botuar disa libra të tipit Salezian (don Bosko, Shën Dominik Savio, Të gjithë më duan vetëm babai jo, Dita me Zotin si dhe 5 leksionarë liturgjikë, një libër këngësh korale dhe gazetën Rrezja e Dritës - organ i Institutit Katekistik Kombëtar, letra dhe dokumente të Pjetër Bogdanit.

Me kalimin tim në Tivar, në vitin 1998, si arqipeshkëv i Tivarit, unë vazhdova me këtë lloj veprimtarie kulturore-fetare, më së pari me formimin e një biblioteke me libra në gjuhën shq-

ipe gjë që nuk ekzistonte fare më parë. Pastaj, vazhdova të merrem me shkrime e botime. Së pari botova dy librat e mi: Duaje Zotin me gjithë zemër dhe Zoti në jetën time.

Mandej, dy libra: Kuvendi i Arbënit (botuar më 2003) dhe dy të don Simon Filipajt: Historia e shëlbimit dhe Drita hyjnore. Dy janë në përgatitje: predikimet e don Simon Filipajt dhe Komentet biblike. Gjithnjë në bashkëpunim të ngushtë me prof. Dr. Anton Nikë Berishën dhe me don Nosh Gjollajn u botuan edhe disa libra tjerë, e sidomos çka është me rëndësi, romani Nëna e Dritës i prof. dr. Anton Nikë Berishës.

Një vit keni qenë administrator i Kishës në Kosovë, një përshkrim të asaj çka keni parë, çka çalon e çka duhet bërë?

Imzot Zef Gashi: Sipas direktivave të Selisë Shenjte atje qëndrova një vit, si administrator apostolik "Ad interim" në udhëheqjen e Kishës në Kosovë me seli në Prizren. Pas kalimit në amshim të imzot Mark Sopit, më 11 janar 2006 dhe varimit që u bë më 14 janar 2006, më 15 janar u mbajt mbledhje e klerit, ku u programuan disa gjëra. Këto takime i kemi mbajtur disa herë me raste të ndryshme e sidomos mbledhjet e konsultorëve gjithmonë me qëllim të një bashkëpunimi sa më të ngushtë.

Ky vit i shërbimeve të mia në Ipeshkvinë e Kosovës përbën një përvojë të re dhe të begatshme për mua. Pjesëmarrja në jetën pastorale nëpër famulli, ishte për mua një kënaqësi e veçantë,

sidomos me rastin e pajtorëve të famullive apo ndarjes së sakramentit të Krezmimit. Ndieja një gjallëri nëpër këto famulli, një vitalitet në mes të të rinjve. Vërtetova, po ashtu, një gjë shumë ngushëlluese e

kjo ishte fakti që njerëzit i duan dhe i respektojnë meshtarët e vet. Po ashtu procesi i edukimit në fe - katekizmi, mendoj se ishte në rregull. Kjo për sa iu përket fëmijëve. Mirëpo, Kisha



Don Anton Kçira, Don Gasper Gjini dhe Imzot Zef Gashi

në Kosovë dhe kleri i saj duhet kushtuar kujdes më të madh të rinjve, nëpërmjet takimeve, tribunave, simpoziumeve etj.

Gjatë gjithë kohës, veprimeve dhe lëvizjeve nëpër Kosovë, kisha ndër mend dhe parasysh vitin 1999 dhe Luftën në Kosovë, të gjitha ato mjerime, tragjedi, vuajtje, vrasje, dëbime etj. dhe lutesha në brendinë e shpirtit që ato të mos përsëriten më kurrë e për këtë jetë.

Për sa i përket pjesës së dytë të pyetjes, çka kam parë, çka çalon

kyer pak a shumë në vendet e veta, ndërtimi kishte marrë hov si askurrë më parë, vendosje rendi për një jetë sa më të qetë e normale, ndonëse nuk ka vend për vetëkënaqësi, sepse ka ende për t'u bërë shumë, për ta arritur ritmin dhe dinamikën e jetës së njerëzve dhe shteteve në Perëndim të Evropës. Duhet bërë përpjekje maksimale me hapa të përshpejtuar për të shkuar krahas me të tjerët. Kosova e orientuar drejt Perëndimit dhe e vetëdijshme për rikthimin e identitetit

të vet është në gjendje t'i realizojë të gjitha aspiratat, sidomos pas arritjes së pavarësisë. Edhe Kisha katolike në Kosovë në krye me bariun e ri dhe klerin, duhet të kyçet në mënyrë intensive në proceset shoqërore për të kontribuar në realizimin e

dëshirave të drejta dhe nevojave të popullit të Kosovës në përgjithësi.

Intervistoi:
Pater Ndue Kajtazi, OFM



gjurmë

Qyteti i Shasit tashmë në rrënoja, me kohë e tërhoqi vëmendjen e kronistëve, udhëpërshkruesve dhe studiuesve historianë, arkeologë, etnologë, si, Giustiniani, Bizzi, Farlati, Degrand, Ippen, etj. Sipas rezultateve nga një gërmim sondazhi të kryer në vitin 1985, janë vërejtur disa faza ndërtimi të qytetit.

Qindra Kisha dhe të qytetit të Shasit

■ Shkruan:
Prof. dr. Jahja DRANÇOLLI

Në një largësi afro 25 km në veriperëndim prej Ulqinit edhe sot ruhen gërmadhat e qytetit të humbur, por jo të harruar të Shasit (Suacium, një toponim i njohur që nga antikiteti). Ndonjë studiues fillimet e qytetit e ndërlidh me periudhën e ndërtimeve të Justinianit (527–565), një perandor bizantin me origjinë dardane. Qyteti në fjalë (edhe pse nuk janë ruajtur shumë njoftime të shkruara për te), me kohë e tërhoqi vëmendjen e kronistëve, udhëpërshkruesve dhe studiuesve, si, Giustiniani, Bizzi, Farlati, Degrand, Ippen, etj.

Është për t'u theksuar se njoftimet e deritanishme për qytete rreth Shkodrës kanë shumë boshllëqe. Këto boshllëqe pamundësojnë edhe njohjen e mirë të lashtësisë së Shasit. Dihet se qyteti në fjalë është gjendur mbi një varg kodrinash shkëmbore të thata prapa njëjës së madhe malore të Lindjes, përkatësisht në anën e majtë të shtratit të lumit Megjuroç, i cili është kthye në një liqe, të quajtur, Liqeni i Shasit. Ky liqe nuk është asgjë përveçse një shtrat lumi i zgjeruar, i gjatë 500 m, që pas shirave të mëdha mund të arrinte deri në 4 km. Lugina e epërme është maçalore dhe e pashëndetshme.

Gërmadhat e qytetit shihen edhe sot

Shasi, *Suacium*, *Sfacia*, *Soacia*, *Suvacium*, it. *Soaço*, *Suaço*, *Suazzo*, ishte emri i një qyteti të njohur dhe të një selie ipeshkvnore nën juridiksionin e arqipesh-

kvisë së Tivarit. Me këtë emër përmendet nga vitit 1067 e deri më 1530. Gërmadhat e qytetit të Shasit shihen edhe sot sipër fshatit të vogël të Shasit që nga vendorët quhen "Kishat". Janë të njohura monedhat e prera me emër të qytetit, ku në njërin anë të monedhës paraqitet fytyra e Shën Gjorit Pagëzuesit, mbrojtës i qytetit, dhe në anën tjetër paraqitet një përkrah me mbishkrim "*Sovaci civitas*".

Muri i këtij qyteti duket se

kishte qytetin të Shasit, Ulqini i zgjerohet rrethet e veta. Po në këtë vit (1406) muri i qytetit ishte në një gjendje të mjerueshme, sa që ipeshkvi i Shasit, si i dërguar i qytetit shkoi në Venedik për të kërkuar leje për rindërtimin e tyre, meqë turqit kishin nisur me i plaçkitur rrethët. Republika e Raguzës për këto qëllime më 1413 ofroi tregull për të mbuluar pullazin e një kisha. Shasi, më pastaj bëhet një pronë e thjeshtë (1443), dhe në vitin 1470, sipas

Përveç këtyre shihen edhe rrënojat e disa kishave, si dhe gërmadhat e një kisha të madhe me altar në përqendër, dhe të një kisha tjetër me mbetje të afreskeve dhe me varrin e një ipeshkvi të quajtur Mark i vdekur në vitin 1262.

Banorët nuk flitnin gjuhë tjetër veç shqipes

Turqit e pushtuan më 1571 dhe ia shkatërruan muret rrethuese dhe godinat në të. Për të shkruar arqipeshkvi i Tivarit *Marin Bizzi*

që ishte një nga sufraganët e Tivarit. Gjendet i vendosur mbi një kodër përsipri një liqeni të kandëshëm, të gjanë e të mbushur me peshq të ndryshëm, me të cilët sidomos mbahen (rrojnë) ata banorë [...]. Është rreth 20 mil larg prej Tivarit. Përballë, në anë të detit, i qëndron qyteti i Ulqinit, që në luftën e kalueme ra në pushtimin e turqve bashkë me Tivarin, që ishin të republikës së Venedikut. Mund të ketë nga 80 shtëpi pothuaj të gjitha të banueme prej të krishtenësh latinë e ma pak turqë. Ka kishën e shën Gjoni Pagëzuesit, shumë të madhe, përveç shumë të tjerave që janë të zbulueme. Ajo [kisha] është shumë keq për çdogja. Mbi altar nuk ka asnjë pala (është fjala për një mbulojë e kelqit), ka vetëm një kryq druni dhe në murë, nën tribunë [balkon] disa fytyra shenjtorësh, pa *batister* e pa *sakrar* (vende të posaçme në kishë për shërbime të ndryshme fetare), sikurse janë gati të gjitha kishat tjera të Arbërisë [...]. Është aty famullitar resident [i qëndrueshëm] d. Lorenzo Mezilli që disa javë ma parë e vendosa unë aty. Banorët nuk flasin gjuhë tjetër veç Shqipes dhe turqishtes [...].

Njoftimet e kryekonsullit austrohungarez në Shkodër, Theodor Ippen

Për rrënojat e qytetit dhe të kishave të Shasit, njoftime të hollësishme ndeshim te Th. Ippen të publikuara më 1899 dhe 1902 (Glasnik Zemaljskog Muzeja u Bosni). Diplomati dhe studiuesi

“Shasi, *Suacium*, *Sfacia*, *Soacia*, *Suvacium*, it. *Soaço*, *Suaço*, *Suazzo*, ishte emri i një qyteti të njohur dhe të një selie ipeshkvnore nën juridiksionin e argjipeshkvisë së Tivarit. Me këtë emër përmendet nga vitit 1067 e deri më 1530. Gërmadhat e qytetit të Shasit shihen edhe sot sipër fshatit të vogël të Shasit që nga vendorët quhen "Kishat". Janë të njohura monedhat e prera me emër të qytetit, ku në njërin anë të monedhës paraqitet fytyra e Shën Gjorit Pagëzuesit, mbrojtës i qytetit, dhe në anën tjetër paraqitet një përkrah me mbishkrim "*Sovaci civitas*".

formonte një katërkëndësh të ngushtë dhe të gjatë në drejtim të kurrit të malit dhe përfshinte edhe të dy shpatullat e tij. Aty shihen dy porta, njëra sipër fshatit, tjetra te shpatulla e pjerrët e liqenit. Qyteti u plaçkitë nga mongolët më 1242, por e mori vetën sërish. Nga viti 1388 nisi dekadencia e shpejtë. Në vitin 1406 në kurrit të Bash-

dokumente venedikase zuri të quhet (fshati i Shasit). Në vitin 1553 shkruante *Giustiniani*, se "muret dhe porta e qytetit ishin ende, gjë që na çuditë veçanërisht" ("Che più meraviglioso"), madje edhe hendeuku nuk ishte i mbushur me lehtë. Sipas përshkrimit të Ippen-it (më 1899) dy porta dhe muret e qytetit ruhehin ende, por në rrënoja.

më 1610:

"Shasi dikur qytet shumë i madh dhe i fortifikuar më së miri, sikurse edhe sot e tregojnë rrënimet e tij. Thuhet edhe se aty pati deri në 365 kishë, d.m.th. aty sa janë ditët e vitit. Tashti është shndërruar e ba fshat, ashtu si ndodh zakonisht me pushtimet e turqve që çdogja shkretojnë e rrënojnë. Kishte dikur ipeshkëv,



Rrënojat e kishave të Shasit sot

ie Kambana sit gjatë mesjetës

në fjalë, nga kapërcylli i shek. XIX kishte bërë rekognoscimin e qytetit të rrënuar të Shasit dhe kishte parë vetëm gërmadhat e qytetit, që vëreheshin mjaft mirë. Aty, në radhë të parë kishte vërejtur tarracën me rrënojen e kishës së ruajtur mirë dhe mbi to qyteti i epërm. Nga poshtë janë parë rrënojat e murit rrethues të qytetit. Në mënyrë të veçantë këndi verilindor, i cili përbëhet nga një bastion i vogël, që ishte ruajtur deri në një lartësi prej dy bojë njeriu. Muri i qytetit që shihet nga liqeni kishte humbur tërësisht.

Një çështje, të cilën e veçonte nga surveu i tij, ishin objektet e kultit, përkatësisht kishat e Shasit. Është e njohur se Ipeshkvia e Shasit zotëronte territor tejet të ngushtë. Ajo është kufizuar nga perëndimi me Tivarin, nga veriu me Shkodrën, dhe nga jugu me Ulqinin. Në dokumente mesjetare ipeshkvi i Shasit përmendet me emra: *Svacinenses, Suacincenses, Soacincenses, Svacinenses, Svatinenses*. Sipas Ippen-it, mbi qytetin e sipërm qëndronte lartë kisha me parg, të cilën e përmendim edhe më sipër. Kisha në fjalë zotëronte një sallë kënddrejtë; mbi altar ishte ngritur pargu i kambanores. Pozita e pargut në këtë kishë ndryshonte nga kishat e tjera, ku ai është gjendur zakonisht në anën balllore. Nga kisha ishin ruajtur vetëm katër mure. Pjesa e brendshme ishte mbushur me rrënoja dhe baroje të mbira midis tyre. Megjithatë, mund të vëreheshin salla dhe narteksi. Kjo kishë (shihet edhe

nga fotot e bëra nga Ippen-i), shihet nga një largësi si pika më e dallueshme e rrënojave të qytetit. Nga rrënojat e kishave të tjera, që ndodheshin mbi tarracën, e cila shtrihet jashtë murit rrethues pranë shpatit lindor të kodrës, Ippen-i kishte veçuar fasadën balllore të një kishë që ishte ruajtur më mirë. Kjo fasadë zotëronte një portë të punuar me kujdes, të mbuluar me një hark rrethor dhe një dritare të ngushtë mbi të. Në këtë fasadë Ippen-i kishte lexuar mbishkrimet e tre gurëve që ishin murosuar në këtë fasadë. Dy kisha të tjera rrënojë, që ndodheshin jo aq larg nga kisha që u përmend më sipër ishin ndërtime të thjeshta. Ndërkaq, nga një kishë e katërt, Ippen-i kishte parë vetëm pak gjurmë muresh mbi sipërfaqe të tokës.

Gërmime arkeologjike

Sipas rezultateve nga një gërmim sondazhi të kryera në vitin 1985 (tetor-nëntor), por të publikuara në vitin 1989, janë vërejtur disa faza ndërtimi të qytetit. Muret rrethuese të shoqëruara me kulla e rrethonin kodrën që përfshinte një sipërfaqe prej afro 2 ha. Duke ndjekur terrenin muret rrethuese krijonin një hapësirë kënddrejtë jo të rregullt, e cila përfshinte një gjatësi prej 230 m, që qonte në drejtim lindje-perëndim dhe gjerësi prej 58 m në drejtim verijug. Qyteti kishte qasje vetëm nga ana veriore, pjesë, e cila është mbrojtur edhe nga një mur tjetër sekondar. Muri rrethues perëndimor dhe lindor me kulla katërkëndëshe është ruajtur më

mirë. Ndërkaq, nga muri jugor kanë mbetur vetëm gjurmët e murit dhe të kullës, që mbi-zotëronte pjesën me shikim nga liqeni. Gjithashtu janë vërejtur shumë rrënoja brenda dhe jashtë mureve rrethuese të qytetit.

Sipas gjetjeve nga gërmim sondazhi në fjalë, me ç'rast në qytetin e epërm të Shasit është zbuluar edhe një shtresë kulturore nga shek. VI, mund të supozohet se, muret veriore të qytetit janë ndërtuar (apo rindërtuar) gjatë periudhës së perandorit Justinian. Në gërmadhat e qytetit, në afërsi të kishës së Shën Marisë është zbuluar edhe material i pasur i qeramikës nga periudha e hershme mesjetare. Me këtë periudhë mund të ndërlidhet edhe ndërtimi i portës veriore dhe jugore të qytetit.

Përveç gjetjeve që u përmendën më sipër, në arealin e qytetit janë zbuluar edhe shumë fragmente qeramike nga periudha e neolitit të hershëm, eneolit dhe bronzi, por më evidente janë gjetjet e kulturës ilire nga periudha e hekurit. Ndërkaq, disa fragmente të gjetura të qeramikës helene shpijnë të supozohet se shtresa helene ka mundur të ekzistonte mu në afërsi të pjesës veriore të qytetit. Fragmente të qeramikës së kuqe dhe të verdhë romake, janë zbuluar në pjesën e qytetit të epërm. Kjo vertikale e gjatë historike e kulturës materiale të Shasit vazhdon të jetonte me intensitet të sforcuar edhe gjatë gjithë shekujve të mesjetës.

“ Shasi dikur qytet shumë i madh dhe i fortifikuar më së miri, sikurse edhe sot e tregojnë rrënimet e tij. Thuhet edhe se aty pati deri në 365 kishë, d.m.th. aq sa janë ditët e vitit. Tashti është shndërruar e ba fshat, ashtu si ndodh zakonisht me pushtimet e turqve që çdogja shkretëtojnë e rrënojnë. Kishte dikur ipeshkëv, që ishte një nga sufraganët e Tivarit. Gjendet i vendosur mbi një kodër përsipri një liqeni të kandëshëm, të gjanë e të mbushun me peshq të ndryshëm, me të cilët sidomos mbahen (rrojnë) ata banorë [...]. Është rreth 20 mil larg prej Tivarit. Përballë, n'anë të detit, i qëndron qyteti i Ulqinit, që në luftën e kalueme ra në pushtimin e turqve bashkë me Tivarin, që ishin të republikës së Venedikut. Mund të ketë një 80 shtëpi pothuaj të gjitha të banueme prej të krishtenësh latinë e ma pak turqë. Ka kishën e shën Gjoni Pagëzuesit, shumë të madhe, përveç shumë të tjerave që janë të zbulueme. Ajo [kishë] është shumë keq për çdogja. Mbi altar nuk ka asnjë pala (është fjala për një mbulojë e kelqit), ka vetëm një kryq druni dhe në murë, nën tribunë [balkon] disa ftyra shenjtorësh, pa batister e pa sakrar (vende të posaçme në kishë për shërbime të ndryshme fetare), sikurse janë gati të gjitha kishat tjera të Arbërisë [...]. Është aty famullitar resident [i qëndrueshëm] d. Lorenzo Mezilli që disa javë ma parë e vendosa unë aty. Banorët nuk flasin gjuhë tjetër veç Shqipëse dhe turqishtes [...]. ”

MARIN BIZZI

kritikë letrare

Letërsia e Atë Gjergj Fishtës (I)

Figura madhore e Fishtës është vlerësuar dhe vlerësohet lart, jo vetëm në fushën e letërsisë, por përgjithësisht në kulturën shqiptare, dimensionet dhe përmasat e të cilit prekin të gjitha sferat me rëndësi kombëtare. Personaliteti i tij ndriçon në kulturën shqipe e në shumë aspekte. Në kulturën e shkrimit shqip, mbetet krijues kulmor, autori më i veçantë, më i shumëllojshëm dhe më i popullarizuar. Portreti i tij poliedrik rrezaton në shumë drejtime në kulturën letrare shqipe. Me fuqinë intelektuale dhe shpirtin e pasionuar artistik, është bërë, për më se një shekull, enciklopedia e shpirtit dhe mendësisë shqiptare, duke mbet zëri më influencues i kulturës letrare shqipe.

■ Shkruan:
Ndue UKAJ

I pari shkrimtar shqiptar i prozuar për çmim Nobel, prozator, poet, përkthyes, "Militant i letërsisë shqipe" – i vlerësuar nga Lasgush Poradeci, për të marrë epitetin emeritum "Poet kombëtar i shqiptarëve" – Eqrem Çabej dhe "Homeri Shqiptar" (Maximilian Lambergi dhe pastaj Engjell Sedaj), Gjergj Fishta do të mbetet për më se një shekull personaliteti më i spikatur i kulturës letrare shqipe, duke u çmuar klasiku më i dalluar i kësaj letërsie. Figura madhore e Fishtës është vlerësuar dhe vlerësohet lart, jo vetëm në fushën e letërsisë, por përgjithësisht në kulturën shqiptare, dimensionet dhe përmasat e të cilit prekin të gjitha sferat me rëndësi kombëtare. Personaliteti i tij ndriçon në kulturën shqipe në shumë aspekte. Në kulturën e shkrimit shqip, mbetet krijues kulmor, autori më i veçantë, më i shumëllojshëm dhe më i popullarizuar. Portreti i tij poliedrik rrezaton në shumë drejtime në kulturën letrare shqipe. Me fuqinë intelektuale dhe shpirtin e pasionuar artistik, është bërë, për më se një shekull, enciklopedia e shpirtit dhe mendësisë shqiptare, duke mbetur zëri më influencues i kulturës letrare shqipe, edhe pse vepra e tij dhe ai vetë përjetuan çmendurinë më të madhe të komunizmit ateist në Shqipëri, kur u ekskomunikua dhe u abuzua me veprën e tij, kur u shtrembërua dhe kur autori për së vdekuri përjetoi tragjien e zhvarrosjes. Me të drejtë Sabri Hamiti shkruan se ky akt vetëm forcon mitin e martirizimit të krijësve shqiptarë, të ngjashëm me Pjetër Bogdanin.

Poet me sens të brumosur artistik, dramaturg me shpirt të rrembyer skenik, lirik me ndjenja të holla e drithërime vibruese, epik me natyrë glorifikuese e diskurs të fuqishëm heroik, Fishta është paradigma më interesante e letërsisë shqiptare të shekullit XX, por edhe letërsisë shqiptare vështuar përgjithësisht. Vepra e tij e gjerë dhe e larmishme, e shkruar brenda një periudhe dra-

matike kombëtare, që përfshin katër decalet e para të shekullit të kaluar, është referenca më e rëndësishme e kulturës letrare shqipe, duke ia dhënë pikërisht fizionominë që i mungonte gjatë shekujve qenësimit të saj.

Me ndjeshmërinë e njeriut të përkushtuar dhe të pasionuar për artin letrar, autori diti të bënte një sintetizim të mrekullueshëm të shpirtit dhe të mendësisë shqiptare, të kaluarës dhe të tashmës, sikur në një pikturë, ku spikaten virtutet dhe veset e kombit, ku rrëfihen degradimet kombëtare dhe ku shihen rrugët e trasuara për një ardhme të ndritshme herë me ngjyra subtile, herë me nuanca të rënda, të ashpra, dramatike. Duke zgjeruar gamën tematike, duke sintetizuar kohë, ngjarje e mënyra më të shumëllojshme të këndimit artistik, autori i dha letërsisë shqipe një dimension të ri. Në mënyrë të jashtëzakonshme diti të harmonizojë estetikën e tekstit dhe tematikën. Me mjeshtëri e dije të kulluar letrare, shkriu empirinë letrare dhe fiksionalitetin, në shtratin e intencës letrare që përplotëson tendencat e letërsisë misionare, me të cilin ideal Fishta ishte i mishëruar plotësisht, për t'u konsideruar apostull i lirisë së atdheut, misionar i letërsisë e kulturës shqiptare, nga se mishëroi në tekste popullin, aspiratat, gjallimin e shpirtin luftarak, natyrën rebeluese, të kaluarën e të tashmen. Ai ndërtoi një univers letrar, një *Olimp Shqiptar*, me qenie mitike e reale, duke ndërtuar kontraste të fuqishme dhe dramatike të letërsisë; madje më dramatikët në letërsinë shqipe. Aty ndeshim diskursin më glorifikues, por edhe diskursin më sarkastik, që bëhen përmes ironisë së hollë, ku autori godet pamëshirshëm. Përmes veprës së vet të larmishme, autori donte të theksonte një aspekt të rëndësishëm për shqiptarët; një identitet kolektiv, që endet si karakteristike e përhershme e veprës së tij. Autori e shqiptari i madh, Fishta, diti t'i himnizojë mrekullisht virtutet shqiptare, shenjat identifikuese nacionale, gjuhën shqipe, flamurin kombëtar, trimërinë, figurat


nacionale, të cilat i personifikon përmes heroit kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu; portreti i së cilit do të endet në mënyrë funksionale dhe domethënëse në gjithë veprën e tij letrare. Fishta, figurë poliedrike, mbetet shembull eklantan e njeriut të ndritur, erudit në shkrim, erudit në kërkimet letrare, së këndejmi erudit edhe në shkrimet e natyrës diskursive analitike. Prandaj ka të drejtë njëri ndër njohësit e mirë të veprës së Fishtës, Atë Daniel Gjeçaj kur shkruan: "*S'do mend se janë të rrallë ata studiues që kur shkruajnë diçka për Fishtën të mos tronditen thellë e të mos i qasen me një kujdes të veçantë veprës së tij, sepse portreti i tij është klasik e aq i lartë sa kishte për t'u dashtë me ardh një tjetër Fishtë për ta paraqitur si duhet pa ia deformuar profilin, pa ju vorgnue ngjyrat*".

Atë Gjergj Fishta, personalitet i rrallë i letërsisë shqipe, i cili më shumë se cili do shkrimtar tjetër i dha shprehje artistike shpirtit kërkes të shtetit të ri sovran shqiptar (Robert Elsie). Fishta ndjente nevojën e ripërtëritjes së kombit. Dhe kjo ripërtëritje duhej bërë përmes njohjes së rrënjëve që lidhen me dimensionet etno-kulturorë, mitike, epiko-historike. Andaj Fishta frymëzohet nga ideale që e karakterizojnë shpirtin shqiptar. Prandaj, i jap të drejtë njëri ndër njohësit e veprës së Fishtës, Janice Mathie-Heck, kur shkruan: "...Unë mendoj se Fishta u frymëzua nga sensi që ata kishin për nderin, drejtësinë dhe trimërinë. Ishte një atdhetar krenar dhe e vështroste Shqipërinë si një komb të rrezikuar, i cili donte të zinte vendin e vet përkrab kombeve të tjera të pavarura të Europës".

Konceptet krijuese të Fishtës, sikundër e riformulon e artikulon teoritë klasike për artin e letërsisë. Në tekstet e tij letrare, autori jetëson konceptet Horacit për të dobishme dhe të këndshmen në art e letërsi (*Dulce et Utile*). Duke ditur që është e dobishme të këndohet kodi i mitit nacional, njësojë diti se është i këndshëm ky lloj kangëtimi për të frymëzuar zemrat djaloshare në lirinë e popullit. Për këtë zgjodhi kurdoherë diskursin substancial, diskurs ky që

korrespondon me mitet dhe kulturën nacionale, që fuqizon tregimet për Orët, Zanat e Dragonjtë, për kujtesën historike, e figurat e dalluara, për ngjarje e personazhe të njohura biblike dhe religjioze. Koncepti krijues e letrar i fishtian, njëkohësisht e dinte dhe e njihte mirë funksionin e letërsisë, funksion ky që lidhet me konceptin aristotelian për *Katharsis-in*. Autori e ndjente se përmes teksteve të tij ai duhet të ndikojë në zemrat dhe ndërgjegjen shqiptare t'i shkundë në vetëdije kombëtare. Më tej, autori në shkrimet e shumta, nuk aplikon

ndonjë metodë letrare, shkollë të caktuar, por i thithi të gjitha diskursin e mundshme, aty ku pretendonte t'i fuqizonte konceptet e lartshënuara. Për të qenë klasik e modern; i kuptueshëm e elitist, stil ky që u formësua përmes koloritit të lloj-lloj ngjyrash poetike dhe që kulmon si një margaritar i rrallë. Në të vërtetë çdo autor ka qëllim originalitetin, edhe atëherë kur është i vetëdijshëm se nuk ka ligjërim virgjër (Roland Barthes), dhe se diskursi personal/fiksional, me vetëdije apo pa të, huazon ligjërimi të njohura, për ta pasuruar Uni-



Atë Gjergj Fishta

“ S'do mend se janë të rrallë ata studiues që kur shkruajnë diçka për Fishtën, të mos tronditen thellë e të mos i qasen me një kujdes të veçantë veprës së tij, sepse portreti i tij është klasik e aq i lartë, sa kishte për t'u dashtë me ardh një tjetër Fishtë për ta paraqitur si duhet pa ia deformuar profilin, pa ju vorgnue ngjyrat. **”**

ATË DANJELL GJEÇAJ

versin Letrar. Nivelet e këllila, si modele të përmendura, i gjejmë në shumë plane të krijimtarisë së Fishtës, veçanërisht tek tekstet themelore, në të cilat autori funksionalizon gjithë potencën krijuese (në epikë të tekstit fundamental *"Labuta e Malcis"*, në lirikë të dy përmblendhet *"Mirizi i Zanave"* dhe *"Valja e Parrizit"*, në dramatikë të tragjedia letrare *"Juda Mukabë"*, në satirikë të *"Anzat e Parnasit"* dhe *"Gomari e Babatit"*.

Diskurset në letërsinë e Fishtës

Artet janë memece (Fraji), andaj duhet kritika t'i bëjë ato të flasin. Semilogu dhe dietari i mirënjohur Umberto Eco shkuan: "Nëse është e vërtetë se të bësh kritikë do të thotë të kuptosh dhe të na bësh edhe në të kuptojmë se si është krijuar një tekst". Ky mision i dyfishtë që na sugjeron Eco, shtreron dy lloje kërkimore që pretendojmë t'i analizojmë.

Me intencën e sprovës së formuluar, diskurset në letërsinë e Fishtës, emëtohet korpusi letrar i Fishtës, domethënë tekstet letrare të fushës së artit (letërsisë), në të gjitha zhanret e krijimit letrar, nëpër të cilat kaloi dhe la gjurmë pena krijuese e autorit; me një intencë sprovuese në imancencën e teksteve letrare; tekste (krijime) këto, të cilat i shqyrtojmë nga prizmi i një kërkimi poetik e letrar, që kërkun stilin e diskursit autorial, si diskurs i veçantë, personal dhe model i konstruktimit të ligjeratës letrare, artikuluar në diskurs letrar e estetik, brenda një sistemi më të zgjeruar, i cili asimilon dimensionin empirik letrar, si pjesë e produktivitetit referencial në shkrim; status ky të cilin e njeh letërsia e Gjergj Fishtës. Ky sistem, në instancën poetike, formësohet nëpërmjet ruajtjes së shenjave dhe kodeve të njohura letrare, në kuptimin e parë, që vijin nga një proveniencë e caktuar kulturore a letrare. Pra në letërsinë e Fishtës, këto janë shprehje, kode a tema të "huazuara" nga referencialiteti dhe që ndërtojnë simbolizmin letrar kryetipor (Northrop Fraji), duke futur në shkrim imazhe letrare, që prekin në kujtesën letrare. Këto trajta e kategori letrare, na shfaqen si pjesë e diskurseve letrare e kulturore të njohura (Linda Hacion), të cilat kurdoherë në veprat letrare të autorit, bartin variante empirike funksionale e evidente, si dhe paraqesin rol të posaçëm në konstruktimin e ligjeratës poetike, brenda universit letrar të Fishtës. Paramodeli e diskurseve (ligjerimeve) qoftë kulturore apo letrare, në evidencuara në kultura të ndryshme të shkrimit, bashkë me diskursin autorial, bashkëjetojnë në letërsinë e tij, përmes një aparature poetike të perfeksionuar me gjetje letrare të nivelit të lartë estetik. Kësaj autori sforcon dhe përmësh dimensionin origjinal universal dhe statusin qëllimor të letërsisë së tij, që ka për tandem shkrimin misionar. Diskurset,

duke u rikualifikuar nga variantet e mëhershme letrare, nga pikëshikimi poetik autorial, përveç se marrin shenjëzime të reja semantike e estetike, nga pozicioni autorit empirik, ato natyrshëm konvertohen dhe marrin konotacione, të cilat ndërliiden me një gjendje kohore letrare dhe retorike, që është qëllim i autorit. Kodet tematike apo diskurset e "huazuara" konotojnë edhe trajta me nuanca dihotomike, duke hibridizuar diskursin personal e autorial ligjerimet e njohura, vetëm sa sforcotet teksti, nga se bëhet pjesë aktive e diskurseve të mëparshme (Linda Hacion). Kategoritë letrare, të përkufizuara si diskurse, të cilat formësojnë stilin e shkrimitar Gjergj Fishta, janë shumëplanëshe, dhe, si të këllila, funksionojnë në kuadrë të sistemit letrar të krijimtarisë artistike të autorit përmes një vetëdije të ngritur letrare, ku dallohet delli i fuqishëm i shqiptimit të botës artistik. Në këtë studim, kemi për synim përkufizimin e disa katëgorive të diskurseve, të hetuara në korpusin letrar të teksteve letrare të autorit, të fushave fundamentale të prodhimtarisë artistike (epikë, lirikë, dramatikë, satirik), në të cilat autori shkëlqeu në mënyrë krejt origjinale dhe ndërtojë modelin letrar të papërsëritshëm. Hulumtimet, qoftë edhe sprovuese, me përcjellje të disa teksteve konkrete, janë një tregues i qartë se letërsia e Fishtës, në shkallë të gjerë formësohet nëpërmjet ligjerimeve letrare të njohura në kulturën letrare dhe për të saj, që vijin nga modele të ndryshme kulturore e religjioze. Në këtë aspekt analizat e tipareve të veçanta dhe të përbashkëta, si dhe statusi i tyre në pozicionin autorial është çelës për të hyrë dhe kuptuar universin e diskurseve që e karakterizojnë letërsinë e Fishtës. Diskursi origjinal, i konceptuar si autorial, është specifik në gjuhë e stil. Ka status të fuqishëm dhe tingëllon fuqishëm në tekst. Ky lloj diskursi përzgjedh një gjuhë të goditur poetike dhe përdor një figuracioni të qëlluar, kryesisht oral e religjioz bibliik. Në këtë rrafsh të konfirgurimit të ligjeratës letrare, autorit del mjaft spirtuoz dhe elokuent në shprehje. Ky diskurs në bashkë-artikullim me diskurset tjera që janë referenciale, të cilat shfaqen analog me tekstet të ndryshme të njohura, qoftë nga oraliteti, mitet, kultura e moçme nacionale, apo edhe nga sferat e filozofisë dhe religjiozitetit, konvertohet në diskursin e veçantë që e ka vulën e stilit fishtian të shkrimit, karakterizuar nga një dramticitet në tekst, një emocionalitet dhe shprehje e përpunuar letrare. Në veprën letrare të Fishtës shohim të sajura disa rrjete tekstesh e

diskursesh: tekste të Shkrimit Shenjtë Bibliik; tekste nga literatura e përbotsme, veçanërisht ajo antike, që mbeten shënues letrarë specifikë. Kjo mënyrë e shkrimitarë, në sistemin e tërësisht poetik, na sugjeron edhe

“Në sistemin letrar të krijimtarisë letrare të Fishtës, me theksime në zhanrin e epikës, te teksti *"Labuta e Malcis"*, Fishta shpërfaq fuqishëm dhe plotënisht diskursin që rezulton nga kultura e letërsia nacionale folklorike, që bënte jetë aktive në Malësi, ku autori kaloi pjesën më të madhe të jetës. Njëherit, ky tekst pasurohet edhe nga mitologjia e pasur vendëse dhe e huaj. Të gjitha këto, të bashkë-artikuluara, të shpërndarë në strukturën e brendshme letrare, me një sens kreacioni specifik formësojnë epin *"Labuta e Malcis"*.”

për shumëplanësinë e diskurseve. Në fakt, kjo formë kreacioni, realizon tekstualitet dramatik; tekstet duke ruajtur inter/shenjat me diskurse të njohura, karakterizohet nga gjuha e gjallë, stili i rrjedhshëm, idetë e shpërthimit dinamike e dramatike, shprehjet e përpunuar letrare, figuracioni i transformuar gjithnjë me gjetje brilante poetike, të thithura nga frazeologjia popullore, apo kultura universale letrare.

Në sistemin letrar të krijimtarisë letrare të Fishtës, me theksime në zhanrin e epikës, te teksti *"Labuta e Malcis"*, Fishta shpërfaq fuqishëm dhe plotënisht diskursin që rezulton nga kultura e letërsia nacionale folklorike, që bënte jetë aktive në Malësi, ku autori kaloi pjesën më të madhe të jetës. Njëherit ky tekst pasurohet edhe nga mitologjia e pasur vendëse dhe e huaj. Të gjitha këto, të bashkë-artikuluara, të shpërndarë në strukturën e brendshme letrare, me një sens kreacioni specifik formësojnë epin *"Labuta e Malcis"*. Ligjerata poetike ndërliiden fuqishëm me kodet tematike e historike. Rrjedhimisht edhe me personazhet e njohura të ambientit shqiptar. Ky lloj i ligjeratës poetike, ruan karakteristikat me formulimet e frazeologjisë popullore, ritmin e melodinë e gjallë, për të formësuar një asociacion të shumëllojshëm artistik, pastaj edhe semantik të tekstit. Në tërësi, sistemi poetik, stilistik brendapërbrenda këtij konstelacioni të shumëllojshëm artistik, pastaj letrar, bën këtë vepër krijim poetik brilant. Diskursi-teksti letrar ruan inter/shenjat me shenja e diskurse popullore e orale, në shumë plane të ndërtimit dhe organizmit të lëndës letrare. Edhe në makro e mikro strukturë. Kënga për *"Tringën"*, përveç se shënjon e hibridizon diskursin letrar autorial; Fishta nga diskursi epik këtu shpërthen në shënjes të treguesit lirik; statusi i këngës ka shenja të pastra lirike dhe, në të njëjtën kohë, kënga shënjon lidhjet e fuqishme interletrare me *"Labutën..."* dhe letërsisë orale, respektivisht shënjon raportin interletrar me këngën e njohur për Gjergj Elez Alinë dhe motrën e tij. Ligjerata poetike, përveç në planin e kodit

tematik, ku spikatet heroina Tringa, e cila shëmbëllen dukshëm me motrën e Gjergj Elez Alinë, edhe në planin e strukturimit të idesë qendrore, ruan shenjat e intertekstit të pastër letrar. Dimensionin interaktiv është i fuqishëm dhe dinamik. Madje modeli referencial thithet edhe në planin e strukturimit të idesë letrare. Teksti trajton trimërinë shqiptare, projektionet morale të autorit për qenien femërore, qenie kjo që vazhdon të jetë tragjike; ashtu siç ngjet në paratekstin poetik, Tringa për të mbrojtur prapin, moralin, virgjërinë, vetëflijohe. Ky vetëfliji është ndodhi që lexuesi i ka të ditur nga varianti i njohur në këngën për Gjergj Elez Alinë. Teksti autorial duke ruajtur në esencë shenjat e fuqishme me paramodelin e këngës në fjalë; në dimensionin autorial, vetëm sforcin variantet e njohura referenciale, idenë, dialogun, sëmundjen, perceptimet, vetëflijimin e motrës. Më tej, teksti në intencë shpërthen në domosdoshë e fuqizimit të këtyre tipareve, nga fakti se rezulton statusi i pavdekësisë në shkrimin letrar-estetik për heroinën. Jo vetëm mënyra e kë-

dimit të luftës shqiptare për liri, e cila thithë poetikën e Këngëve Kreshnike, pastaj Këngëve historike, si dhe legjendave për qenie mitologjike, përkshon tekstin e *"Labutës..."*, brenda tridhjetë këngëve, por edhe ritmi e melodia aq popullore, të cilat i japin një karakteristikë të veçantë poetikës së epit. Të gjitha këto, kur autori insiston fuqishëm në fuqizimin e raportit të ndërlloqshëm e intencional: *Atme e Fe*. Afria në planin e kompozicionit, në planin stilistik, pastaj edhe në kodet tematike, me variantet e njohura letrare, e bën *"Labutën..."* krijim kulmor epik në literaturën shqipe, të përpunuarara mjeshtërisht nga dora e krijësut me dell të fuqishëm artistik. Që të shfrytëzohet kjo materie letrare, përveç edukimit të poetit ka ndikuar në përmasa të mëdha gjendja e kombit në përgjithësi, kontekstet socio-kulturore, që në tërësi i dhanë frymëzim në vullkanet krijuese autorit. Andaj tipet e diskurseve që i gjejmë brenda letërsisë së tij janë të shumëllojshme: ato janë orale, mitike, biblike, klasike, për t'u pasuruar fuqishëm përmes pikëshkimeve fiksonale. Kësopare, poetika e letërsisë fishtiane është e realizuar në shkallë të gjerë. Aty literariteti (Roman Jakobsoni) funksionon para se gjithash, përmes shenjave e simboleve që shprehin qenësinë shqiptare, qenësi që pikaset përmes *Malit, Dashutisë* dhe *Dhembejes Autoriale*.

(vazhdon në nr. e ardhshëm)

ARTI I HAPAVE TË VEGJËL

Antoine de Saint-Exupéry

Nuk po të lutem, O Zot, për mrekulli dhe parashikime, po për të gjetur forcë në jetën e përditshme.

Ma mëso artin e hapave të vegjël.

Më bëj të sigurt në kohë kërkim-falshje. Ma ndriço mendjen që të di të dalloj ç'është më e rëndësishmja e çka më pak e rëndësishme.

Të lutem, më jep forcën e arsyes që t'i zgjedh/pëlqej vetëpërbajtjen dhe maturinë, që gjatë jetës të mos rrëshqas, por që me arsye ta shquaj rëndin e ditës, të vërej dritën dhe majat, që herë pas here të gjej kohë për të bukurën, artin dhe kulturën.

Më lejo që të kem vetëdijen për ta kuptuar mirë se ëndrrat për të ardhmen nuk të çojnë larg. Më ndihmo që të veproj mirë e drejtëpërdrejt, që çastin e tashmë ta rinjoh si më të rëndësishmin.

Më ruaj nga qëndrimi naiv se në jetë çdo gjë mund të tejkalohet. Më jep dhuntinë e njohjes së qartë të kuptoj se vështirësitë, dështimet dhe vështirësitë janë përcjellës të përhershëm të jetës – krahas të cilave rritemi dhe arrijmë pjekurinë.

Ma përkujto se zemra shpeshherë e turbullon arsyen. Në çastin e duhur më dërgo miq, të cilët do të ma thoshin me aq durim të vërtetën.

Gjithmonë do t'u lëshoj udhë njerëzve dhe Ty që të më flisni. Të vërtetën nuk mund t'ia themi vetvetes, ajo na thuhet. Ti e di se sa na duhet miqësia. Të lutem, na e krijo mundësinë që të jemi të denjë për këtë dhuratë kaq të bukur, kaq të kërkuar dhe kaq të ndjeshme.

Më dhuro kaq imagjinatë, që, në çastin e duhur e në adresë të duhur të dërgoj shërbimin postar të një pakoje të vogël të mirësisë, me një letër përcjellëse ose edhe pa të.

Krijoje nga unë njeriun që do të hapë thellë vazhden bri anijes, që t'i prekë sadopak edhe ata që janë "poshtë".

Më liro nga frika në mos po e lënkam mënjana jetën. Mos ma dhuro atë që e dëshiroj, po atë që më duhet.

Më mëso artin e hapave të vegjël.

Përktheu:
Prend Buzhala

KANUNI *nuk lejon* TREGËTINË *e grave*

Reagim artikullit: "Raporti i turpit", Gazeta Express, e enjte, 19 korrik 2007, f. 8-9

Në fillim të shek. XX shqiptarët dhe Shqipëria bëhen vend i aventurave perëndimore. Vizitorë të ndryshëm nga Evropa posa ktheheshin nga rruga e tyre, dhe pas vizitave edhe në Shqipëri, ata, si një nga pikat kryesore në përjetimet e tyre, merrnin e shkruanin për zakonet shqiptare dhe për elementin e gjakmarrjes. E drejta zakonore shqiptare bëhet element i pandashëm i shumë autorëve të ndryshëm perëndimorë, shumica e të cilëve njihen edhe nga kryesurit shqiptarë. Ky trend ka mbetur gjallë edhe në ditët e sotme. Kanunin sot në disa nga mediat perëndimore, e, sidomos të ashtuquajturit njohësit *ad hoc* të kulturës shqiptare, shpesh po e vejnë në lidhje edhe me krimet e ndryshme që po ndodhin në vendet e ndryshme perëndimore nga përbërësit shqiptarë.

E drejta zakonore shqiptare duket se po i ndihmon kriminelët shqiptarë për t'u arsyetuar duke iu referuar këtyre normave. Sipas gazetës "Express" të Kosovës: "Europoli ka publikuar raportin e turpit për shqiptarët. Ata janë të parët në trafikimin e grave dhe fëmijëve në Evropë, për qëllime seksuale." Dhe se kjo qëndron në lidhje edhe me Kanunin ku në raport thuhet: "Kanuni i Lekë Dukagjinit, një kod i cili ende ekziston që nga periudha e mesjetës, flet për të drejtën që kanë burrat të tregojnë gratë si plaçkë."

Sot Kanuni dhe normat e tij janë duke u keqpërdorur dhe keqinterpretuar në thelb. Dhe tani së fundi kjo ka ndodhur edhe me konstatimin në raportin e Europolit (duke u mbështetur në gazetën e cekur). Thirrja e kriminelëve sot në normat e

sjelljes që i jep Kanuni është një shkelje e paskrupull. Edhe më i pandershëm dhe krejtësisht i gabueshëm është konstatimi se Kanuni po e avancuak krimin si trafikimin e grave dhe fëmijëve!

Të nisemi me disa sqarime. E drejta zakonore shqiptare ka qenë një sistem më vete për rregullimin e raporteve brenda shoqërisë ku ai është aplikuar. Dhe, për të mos hyrë në detaje, pse ai edhe sot ushtron ndikim, ka arsye të ndryshme. Për fat të keq, sot kriminelët po iu referohen këtyre rregullave. Mirëpo, një pikë thelbësore është duke u lënë përherë anash. Dhe ky është fakti se Kanuni dhe rregullat e tij kishin për qëllim luftimin e të keqes. Pra ishin norma që rregullonin raportet shoqërore e që ishin ndërtuar për ta ruajtur qetësinë e bashkësisë. Sot nëse një kriminel droge, apo tregtar i qenieve të gjalla mbështetet në Kanun, bën një bastardim tejet maksimal e të mundshëm që mund t'i i ndodhë kësaj të drejte zakonore shqiptare. Po ashtu, edhe më i rëndë është konstatimi se burrat paskan të drejtë të trajtojnë gruan si "plaçkë". Fundja, për tu thirrur sot në normat e së drejtës zakonore, atëherë edhe shkelja e normës duhet të trajtohet përbrenda sistemit kanunor. Dhe nëse kjo ndodh, atëherë abuzimi seksual (tregtia me qeniet e gjalla për tregtinë e seksit) sipas kanunit janë shkelje shumë e rëndë e nderit të familjes shqiptare. Dhe kjo shkelje e nderit mund të "pastrohet" vetëm me anë të "pushkës" ose "me falje".

Nëse konstatohet se Kanuni po e lejuak tregtinë e qenieve njerëzore, atëherë ky është devijimi më arbitrar që mund t'i bëhet këtij kodi. Gruaja në kanun është

e mbrojtur. E mbrojtur për faktin se sipas natyrës ajo nuk ka forcë të barabartë me mashkullin dhe si e tillë ajo ka pasur disa mbrojtje dhe favorizime. Bie fjala, gjakmarrja në grua, apo në prezencën e saj, sipas kanunit ka qenë qyqarllëk. Vërtet, femra shqiptare është fejuar sipas kërkesave të familjes, më së shpeshti edhe është kërkuar një lloj shpërblymimi për dhënien e vajzë, mirëpo kjo nuk ka qenë fare e natyrës së "tregtisë" që po na i thotë raportin në fjalë. Një nga sfidat që ka



përfjetuar Shqipëria pas kthesës (rënies së komunizmit) ka qenë sfida e rehabilitimit të vajzave shqiptare të mashtruara nga kriminelë shqiptarë, se atyre do t'u ofrojnë punë në perëndim, e të cilat janë të detyruara të punojnë si prostituta në qendrat e ndryshme evropiane.

Nëse kriminelët mbështeten në normat e Kanunit, kur ata bëjnë tregti me femrat për qëllime prostitucioni, atëherë atyre duhet t'u bëhet me dije se kanuni një vepër të tillë e dënon me "pushkë", sepse me një sjellje të tillë

preket nderi i familjes, por edhe i vetë personit të prekur. Andaj, sot të konstatohet se normat zakonore shqiptare e lejojnë tregun e femrave për prostitucion, është ofendim i rëndë që i bëhet këtij thesari historik shqiptar dhe vetë popullit shqiptar.

Nuk është për t'u habitur. Edhe sot në mediat perëndimore kemi tendencën e paraqitjes së Kanunit si element në gjenezën shqiptare, i cili po e mbrojtka krimin. Kjo ndodh shpesh edhe për shkak të deklarimeve të shqiptarëve, të cilët për t'i mbrojtur poshtërsitë e tyre, thirren në atë se kjo është "kultura jonë", ndërsa e mirëseardhur është për ata që është kriminel shqiptar dhe se ku e ka bazën. Sot kemi një dallim të madh mes realitetit dhe asaj se sa e njohin vërtet të drejtën zakonore shqiptare.

Le të nisemi edhe nga një interpretim tjetër. Historia e popullit shqiptar nuk njeh faktin se ky popull në gjirin e vet ka pasur skllav. Elementi i të qenit skllav te shqiptarët ka qenë jo i pranueshëm, po ashtu siç kanë qenë e papranueshme edhe format e ndryshme të dënimeve. E drejta zakonore shqiptare nuk i njihë dënimet trupore, llojet e gjymtimeve apo torturat që njihen historinë e të drejtës penale te popujt e ndryshëm, pasi ato nuk ishin në kundërshtim me nderin e burrave. Prej llojeve të ndryshme të dënimeve me vdekje, si varja, prerja e kokës, varrosja gjallë, mbytja (në ujë), djegia, zierja në ujë apo vaj, e drejta zakonore shqiptar njihje vetëm djegien. Llojet e ndëshkimeve gjymtuese, si psh. prerja e dorës, prerja e gishtërinjve apo thonjve, shkëputja e këmbëve, prerja apo

qërimi i gjuhës, nuk njiheshin nga Kanuni.

Nëse bëjmë një krahasim me konceptin e fjalës skllav të kohërave të mëhershme historike me tregtinë sot të femrave për prostitucion, del se kemi një skllavërim modern – pra sot edhe organizatat e ndryshme kanë deklaruar dhe kanë krahasuar tregtinë e qenieve njerëzore, sidomos të femrave me qëllim për ta ushtruar prostitucionin, si formë e skllavërimit modern. Sado që në traditën shqiptare bëhet fjalë për "rob" të shtëpisë, kjo nuk e ka kuptimin e skllavit. Me gjithë sistemin patriarkal të familjes shqiptare kishte një liri për secilin individ. Dhe kjo del edhe nga kanuni i Lekë Dukagjinit.

Duke pasur parasysh edhe faktin se e drejta zakonore është e ngritur në bazën e shprehjeve anekdotike, dhe, nëse marrim në konsideratë nga shumë prej anekdotave të ndryshme që dalin nga gjiri i popullit, del se femra është: "shtylla e shpisë", "nderi i familjes", "gruaja të ban shpi, e gruaja të fik", ose "nderi i burrit është gruaja" etj. etj.

Zef Ahmeti

Lit.: Tonin Çobani, Princi i përfolur Lekë Dukagjini, Tiranë 2003; Aleks Laurasi, E drejta zakonore shqiptare, në: Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri (grup autorësh), Tiranë 2001, fq. 229-274; At Giuseppe (Zef) Valentini, Veptra I, Tiranë 2005, fq. 663-744; Aleks Laurasi, Marrëdhëniet familjare, Studime për të drejtën zakonore shqiptare, Tiranë 2003; Zef Ahmeti, E drejta penale në Kanunin e Lekë Dukagjinit, në: Urtia, nr. 1-2, Zagreb 2003, fq. 37-53; Stephane Voell, Das nordalbanische Gewohnheitsrecht und seine mündliche Dimension, Marburg/Lahn, 2004.

PRITA

Të nderuar/a lexues/e!

Kjo faqe është rezervuar për ju, për opinionet, sugjerimet dhe komentet për sa i përket DRITËS, si dhe dukurive të tjera nga jeta jonë shoqërore, kulturore, fetare... etj.

Fjala Juaj do të jetë nderim dhe kontribut për ne. Faleminderit!

Këshilli redaktues i DRITËS

Email për ju: revistadrita@yahoo.com; revistadrita@hotmail.com

LIBËR I MEDITIMIT DHE PËRTHELLIMIT NË FE

Imzot Nikë Prela, Vështrime dhe meditime, (përmbledhi: Don Lush Gjergji; Përktheu nga kroatishtja: Don Fatmir Koliqi), Drita, Prizren 2006, fq. 125.

Imzot Nikë PRELA

VËSHTRIME DHE MEDITIME



Prizren
2006

Kjo vepër është një përmbledhje e artikujve të Imzot Prelës, të cilët ai i kishte botuar vite me radhë në revistën kroate katolike "Vrelo života". Falë kujdesit dhe angazhimit të Don Lush Gjergjit, i cili bëri përmbledhjen e këtyre artikujve të vlefshëm, këto shkrime do të shohin dritën edhe si libër që u botuan në gjuhën kroate, pikërisht në njëvjetorin e vdekjes së Imzot Prelës, nga shtëpia botuese "Kršćanska Sadašnjost" në Zagreb në vitin 1997. Librin në fjalë, nga kroatishtja e përktheu don Fatmir Koliqi, ndërsa u botua nga shtëpia botuese "Drita" në Prizren, në 10-vjetorin e vdekjes të Imzot Prelës.

Dihet se përpos angazhimit dhe flijimit të madh të Imzot Prelës në fushën baritore si ipeshkëv, ai veçanërisht i ka kushtuar një rëndësi të madhe fushës së shkrimeve, edhe atë në lëmi të ndryshme si ato me karakter fetar, po ashtu edhe sociologjik, filozofik etj. Të gjithë ata që e kanë njohur Imzot Prelën, nuk mund e të mos e përmendin faktin se ai, ndër vetitë tjera të mira që kishte, ishte guximtar i madh kur duhej thënë, shkruar apo edhe kur duhej mbrojtur e vërteta. Këtë e zbulojmë edhe në shkrimet e tij, megjithëse ndoshta ai vetë nuk ka dashur që kjo të tingëllonte kështu. Këtë e vërejmë edhe në librin e tij "Vështrime dhe meditime".

Metodologjia të cilën ndjek gjatë shkrimit, na bën ta njohim atë si një atë shpirtëror të mirë dhe të zellshëm, i cili flet me një thjeshtësi dhe përvujtëri të madhe, pastaj si një mësues që këshillon për të mirë të dashurit e vet, por edhe si një udhëheqës, i cili qorton me dashuri për të mirën e përbashkët. Këtë mund ta pohojmë lirshëm, duke

u bazuar në pjesën e parë të librit në të cilën autori shqyrton figurat e apostujve. Ai flet me një stil të lehtë dhe të kuptueshëm për të gjithë. Pastaj, ajo që lë mbresa edhe më tepër, është fakti se autori, përpos që flet mbi apostujt e "mëdhenj" siç i quan ai, shqyrton edhe figurat e apostujve për të cilët nuk ka shumë shënime për jetën e tyre. Ata i quan me një shprehje karakteristike "statistë, për shkak të anonimitetit të tyre, megjithëse edhe këta e bartën dramën mallëngjyese të shëlbimit dhe e kumtuan Lajmin e Gëzueshëm" (fq. 39).

Përpos apostujve, autori me një mjeshtri të madhe, që pa dyshim shihet se është fryt i meditimit dhe përthellimit të tij në fe, na paraqet edhe disa figura tjera biblike, siç janë të bijtë e Zebedeut, Jozefi prej Arimateje dhe Nikodemi etj., dhe arrin të depërtojë në rrethanat e kohës së atyre njerëzve për të cilët shkruan, duke na lënë të kuptojmë se sinjerisht është i mishëruar me temën që trajton. Kjo i jep atij mundësinë të nxjerrë mësim nga jeta e tyre për të sotmen tonë, e cila ka nevojë të mbështetet në të vërtetën si parim i ndërtimit të ndritshëm të së ardhmes.

Kjo mënyrë e trajtimit të argumenteve në fjalë, na bën të mendojmë për shpirtin e madh meditativ e vështrues të Imzot Prelës, siç shprehet Imzot Zef Gashi në parathënieën e këtij libri. Pjesa tjetër e librit përmban disa tema tjera, të cilat dallojnë në esencë njëra prej tjetrës. Mirëpo, secila prej tyre ka rëndësinë e vet të madhe dhe të çon kah një qëllim i përbashkët i tyre. Për nga përmbajtja e përafërt e tyre mes veti, në to bëhet fjalë për shpirtin flijues dhe martirizues të njerëzve, të cilët kanë gjetur kuptimin e plotë të jetës së tyre. Këtu autori veçon martirët e parë të Kishës. Në anën tjetër, në disa prej temave tjera, autori nxit me një guxim të madh, që Kisha dhe njerëzit e kushtuar të ballafaqohen me gjërat e reja të cilat duhet ta kenë vendin në Kishë, si mjete që do ta ndihmonin atë në rrugëtimin kah përtëritja e vazhdueshme.

Thënë përgjithësisht, libri "Vështrime dhe meditime" është një vepër që mund të lexohet lehtë me mundësinë që të meditojmë veç e veç për secilën temë. Tematika që trajtojnë artikujt mbetet gjithmonë aktuale. Urojmë të jetë frytdhënëse edhe për gjithë lexuesit që do ta marrin në dorë.

Don Agim Qerkin

Ndërmarrja e specializuar për:

qirinjë dekorativ, aromatik, për ndriçim dhe destinime të tjera,
letrër dekorative dhe produkte të saj me dizajne të ndryshme.



GECE AUTOKTON

Janosh - Gjakovë

mob: 044/122 741

/235 948

